



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 96

Tiranë – E premte, 18 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 64/2021, datë 20.5.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”..... 9463
Vendim i Kuvendit nr. 56/2021, datë 14.6.2021	Për miratimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Shqipërisë, 2020–2025 9463
Rezolutë e Kuvendit datë 14.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020..... 9470
Rezolutë e Kuvendit datë 14.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2020..... 9472
Rezolutë e Kuvendit datë 14.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020..... 9474
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 16.6.2021	Për miratimin e rregullores për shishet enëmatëse..... 9477
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 16.6.2021	Për konstatimin e përfundimit të mandatit të anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Rrugor Shqiptar..... 9482
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 16.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Itinerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial”, Tiranë..... 9482
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 16.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Për ndërtim, përmirësim, shfrytëzim, mirëmbajtje të autostradës ‘Milot – Morinë’”..... 9484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 16.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Allamani’, Fushë-Krujë”..... 9488

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 16.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Porti i Jahteve – Bypass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)”.....	9489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 16.6.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë, me 1 800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit, me 1 200 l/sek”.....	9492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 356 , datë 16.6.2021	Për përcaktimin e kriterëve për dhënien dhe kohëzgjatjen e pushimeve për punonjësit e Policisë së Burgjeve.....	9494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 16.6.2021	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ministri i Shtetit për Rindërtimin, dhe Korporatës “Oracle”, për dhurimin e së drejtës për të aksesuar dhe përdorur sistemin elektronik “Oracle” të menaxhimit shëndetësor për COVID-19.....	9495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 359, datë 16.6.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese.....	9500
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 16.6.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë dhe caktimin e Bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese.....	9500
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 16.6.2021	Për shfuqizimin e vendimit nr. 130, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.....	9501
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 16.6.2021	Për shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.....	9501



LIGJ
Nr. 64/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN
NR. 48/2014, “PËR PAGESAT E
VONUARA NË DETYRIMET
KONTRAKTORE DHE TREGTARE”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Neni 8, “Zgjatja e afateve për autoritetet publike”, shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.5.2021.

VENDIM
Nr. 56/2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT
STRATEGJIK TË KUVENDIT
TË SHQIPËRISË, 2020–2025

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në vendimin nr. 64, datë 29.12.2020 të Byrosë së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Plani Strategjik i Kuvendit të Shqipërisë, për periudhën 2020–2025, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Byroja e Kuvendit është organi përgjegjës për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planit Strategjik.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.6.2021.

PLANI STRATEGJIK
I KUVENDIT TË SHQIPËRISË
2020–2025

PËRMBAJTJA
PARATHËNIE NGA KRYETARI I KUVENDIT
I. HYRJE
II. PROFILI I KUVENDIT
III. VIZIONI
IV. MISIONI
V. VLERAT THEMELORE
VI. FUSHAT PRIORITARE, QËLLIMET
STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT STRATE-
GJIKË
VII. ZBATIMI DHE MONITORIMI
VIII. SHTOJCA 1. PLANI I VEPRIMIT PËR
ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË
KUVENDIT, 2020–2025

¹ Ky projektligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.



PARATHËNIE NGA KRYETARI I KUVENDIT

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 dhe Plani i Veprimit, si dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës i degës legjislative të qeverisjes së Shqipërisë, prezanton vizionin, misionin, vlerat themelore, si dhe drejtimit kryesor të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë në përgjigje të sfidave të rëndësishme që qëndrojnë para ligjvënësve shqiptarë dhe para vendit.

Procesi i integritimit evropian, përfundimi i reformës zgjedhore, mbështetja e reformës në drejtësi, rritja e produktivitetit dhe modernizimi i ligjbërjes, forcimi i kontrollit parlamentar janë disa nga drejtimit kryesor në të cilat është përqendruar aktualisht veprimtaria e Kuvendit.

Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës, është gjerësisht i përfshirë dhe luan një rol kyç në procesin e integritimit evropian. Garantimi i legjitimitetit demokratik, kontrolli ligjor dhe monitorimi politik i procesit të integritimit janë tri kontributet kryesore të ligjvënësve në procesin e integritimit evropian.

Vendimi i Këshillit Evropian i 26 marsit 2020 për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, përveçse një fitore e madhe politike dhe kombëtare e Shqipërisë është dhe një hap i rëndësishëm i afrimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian, i zbutjes së asimetrive politike dhe kulturore të integritimeve evropiane dhe i afrimit të kufijve politikë e kulturorë të Evropës drejt kufijve gjeografikë e natyrorë të saj.

Por vendimi për çeljen e negociatave, përveçse një arritje është dhe një sfidë. Kuvendi, qeveria dhe të gjitha institucionet e Shqipërisë kanë përpara detyra mjaft të rëndësishme, thelbësore e jetike për rrugëtimin tonë evropian, të cilat burojnë nga rekomandimet e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Bundestagut gjerman.

Kuvendi ka filluar nga puna për zbatimin e tyre dhe jo rastësisht prioritetet e punës së ligjvënësve shqiptarë përputhen me jetësimin e këtyre rekomandimeve.

Reforma zgjedhore, shumica e objektivave të së cilës janë realizuar dhe që do të përfundojë brenda sesionit parlamentar të vjeshtës 2020, do të krijojë kushtet dhe mundësi të barabarta për një garë të ndershme elektorale në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 dhe më tej. Kjo reformë do të

kurorëzohet në mënyrë gjithëpërfshirëse me mbështetjen e opozitës parlamentare dhe asaj jashtëparlamentare dhe, çka është më kryesorja, me mbështetjen e shumicës së opinionit publik dhe të qytetarëve shqiptarë.

Kuvendi do të mbështesë me vendosmëri zbatimin dhe progresin e reformës në drejtësi, bërjen funksionale sa më shpejt të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, vazhdimin dhe thellimin e procesit të *vetting*-ut, parandalimin dhe dënimin e shitblerjes së votave, angazhimin e Prokurorisë dhe të Gjykatës Speciale dhe arritjen e rezultateve të dukshme e të matshme në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Kuvendi, komisionet dhe ligjvënësit do të vazhdojnë të prodhojnë ligje cilësore, të cilat do t'i paraprijnë integritimit evropian të Shqipërisë, mbështetjes së zhvillimit të ekonomisë dhe rritjes së mirëqenies, sidomos në kushtet e vështirësive që janë krijuar nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e COVID-19.

Qëllimi ynë është që dinamizmi dhe energjitë me të cilat Kuvendi dhe ligjvënësit përballuan e po përballojnë këto fatkeqësi natyrore të shndërrohen në vlera të përhershme dhe të sendërtohen në funksionet e kontributit të të gjitha institucioneve dhe të qytetarëve të Shqipërisë.

Forcimi i kontrollit parlamentar ndaj qeverisë dhe monitorimi i mbështetja e institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, si rojë të interesit publik dhe qytetar, do të jenë gjithashtu një prioritet i Kuvendit edhe në vitet që vijnë.

Këto sfida të vështira, por fisnike, pjesë e përgjegjësisë dhe kontributit kombëtar të Kuvendit të Shqipërisë, kërkojnë një trupë ligjvënës energjike e të kulturuar, të përgjegjshme e produktive, të përkushtuar e llogaridhënës.

Shqipëria ka nevojë për një Kuvend të fortë, përfaqësues, efektiv dhe për njerëzit, të mbështetur në kuitencën e vlerave tona më të arrira politike, shoqërore, njerëzore e kombëtare.

Këtij qëllimi fisnik i shërben edhe hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Kuvendit, i cili është përcaktuar si një prioritet i Kuvendit edhe në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian 2020–2022 dhe si një masë e veçantë në Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019.



Si dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës, Plani Strategjik ndërthur dhe harmonizon prioritetet e zhvillimit të Kuvendit të Shqipërisë, të trupës ligjvënëse, të strukturave dhe të shërbimeve të Kuvendit në mbështetje të tyre.

Hartimi i këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik për Kuvendin e Shqipërisë është realizuar edhe me kontributin e projektit “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri” (2018–2022), financuar nga qeveria e Konfederatës Zvicerane (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) dhe partnerët zbatues: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Kombëtar Demokrat i SHBA-ve, për të cilët gjej rastin të shpreh vlerësimin e mirënjohjen time dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

Gramoz Ruçi

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I. HYRJE

Përmbledhje ekzekutive

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 përcakton prioritetet e zhvillimit të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2020–2025 për të përmbushur me sukses vizionin dhe misionin e tij si dhe për të arritur standardet më të larta të demokracisë parlamentare.

“Plani strategjik” është konceptuar si një udhërrëfyes që ndërthur vizionin, misionin, vlerat themelore, fushat prioritare, qëllimet strategjike dhe objektivat strategjike, si dhe masat konkrete për përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit në kushtet e një mjedisi veprues që ndryshon vazhdimisht.

Plani Strategjik i Kuvendit është dokumenti i parë strategjik gjithëpërfshirës i institucionit që përcakton drejtimit kryesor të zhvillimit të tij, duke përfshirë deputetët dhe administratën.

Vizioni i Kuvendit është: *Kuvend përfaqësues, efektiv, eficient dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese. Plani Strategjik e përshkruan deklaratën e misionit të Kuvendit si vijon: “Ligjvërje cilësore dhe kontroll parlamentar i fortë, pranë qytetarëve, për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin evropian të Shqipërisë”.*

Në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij Kuvendi i Shqipërisë do të udhëhiqet nga këto vlera themelore: përfaqësimi, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja,

barazia dhe mosdiskriminimi, transparenca, integriteti dhe etika, profesionalizmi dhe kompetenca, paanësia politike

Plani Strategjik përcakton katër fusha prioritare të zhvillimit të Kuvendit për periudhën 2020–2025:

1. Efektiviteti i ushtrimit të funksioneve përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës.

2. Roli i Kuvendit në proceset integruese dhe diplomacia parlamentare.

3. Transparenca, pjesëmarrja dhe edukimi qytetar në veprimtarinë e Kuvendit.

4. Kuadri rregullator, burimet njerëzore dhe infrastruktura.

Plani Strategjik përcakton qëllimin strategjik dhe objektivat strategjike për çdo fushë prioritare.

Qëllimet strategjike, sipas fushave prioritare, janë:

- rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare;

- forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian dhe i diplomacisë parlamentare;

- rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit;

- përmirësimi i kuadrit rregullator, forcimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës.

Plani Strategjik përcakton 19 objektiva strategjike të Kuvendit, për periudhën 2020–2025, nga të cilat 6 objektiva për prioritetin e parë, 4 objektiva për prioritetin e dytë, 4 objektiva për prioritetin e tretë dhe 5 objektiva strategjike për prioritetin e katërt.

Plani Strategjik i Kuvendit 2020–2025 shoqërohet nga Plani i Veprimit për zbatimin e tij (shtojca 1), që përmban aktivitetet konkrete për realizimin e secilit objektiv strategjik, të cilat do të realizohen gjatë periudhës 2020–2025. Për çdo aktivitet të parashikuar në Planin e Veprimit (124 aktivitete) janë përcaktuar treguesit e performancës, struktura përgjegjëse për zbatimin e tij, afati i realizimit dhe efekti financiar shtesë (nëse ka), sipas burimeve të financimit (buxheti i Kuvendit dhe /ose donator). Ndikimi i Planit Strategjik në përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit, si dhe progresi drejt arritjes së vizionit të Kuvendit do të varet nga zbatimi i plotë i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. Plani i Veprimit do të monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve periodike dhe do të rishikohet çdo vit nga Byroja e Kuvendit me qëllim përshtatjen e tij.



Procesi i hartimit të Planit Strategjik të Kuvendit, 2020–2025, është mbështetur nga OSBE-ja dhe NDI-ja, në kuadër të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar”².

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit, 2020–2025, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij është bazuar, ndër të tjera, në:

- Analizën e plotë të mjedisit veprues të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, që ndikon në realizimin e misionit dhe zhvillimin e Kuvendit të Shqipërisë, realizuar me nivelin drejtues politik dhe administrativ të Kuvendit. Është realizuar analiza SWOT, nëpërmjet së cilës u evidentuan pikat e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe rreziqet, të cilat u reflektuan në përcaktimin e fushave prioritare të Planit Strategjik, qëllimit dhe objektivave strategjikë, si dhe masave konkrete të konceptuara në planin e veprimit për përmbushjen e objektivave strategjikë.

- Modelin e “*Teorisë së ndryshimit*”, e cila përshkruan mënyrën dhe arsyen se pse një ndryshim i dëshiruar pritët të ndodhë në një kontekst të caktuar³.

- Dokumente strategjike kombëtare (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020) dhe sektoriale (Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2020–2022).

- Angazhimet dhe standardet ndërkombëtare lidhur me funksionimin e parlamenteve kombëtare⁴, si dhe angazhimet dhe detyrimet që burojnë direkt për Kuvendin nga aktet dhe raportet

e monitorimit të organizmave ndërkombëtarë ku Shqipëria është palë⁵.

- Konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna për Kuvendin në aktet e institucioneve të BE-së për Shqipërinë⁶, në aktet e strukturave të përbashkëta BE–Shqipëri⁷, si dhe në raportet e ekspertëve të BE-së, në kuadër të zbatimit të projektit të binjakëzimit “Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në kontekstin e pranimi në BE” (IPA 2014).

- Marrjen e ekspertizës vendëse dhe ndërkombëtare me ekspertë nga parlamenti austriak, parlamenti grek, parlamenti danez (me mbështetjen e OSBE-së), Bundestagu gjerman, parlamenti slloven, parlamenti kroat dhe eksperti i NDI-së për Institutin Parlamentar. Ekspertiza vendëse dhe ndërkombëtare mundësoi zbatimin e standardeve më të përparuara evropiane për hartimin e një dokumenti strategjik për parlamentet.

- Transparencën, gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e pjesëmarrësve në proces, duke filluar nga Sekretari i Përgjithshëm, deputetët, kabineti i kryetarit të Kuvendit, drejtuesit, punonjësit, konsulentët, grupet e interesit që bashkëpunojnë me Kuvendin të përfshirë direkt apo indirekt në Planin Strategjik.

- Konsultimin e brendshëm, që përfshiu të gjithë deputetët dhe administratën e Kuvendit (stafin civil dhe politik) dhe u realizua përmes disa tryezave të përbashkëta si dhe pyetësorit për këtë qëllim.

- Konsultimin e jashtëm, i cili konsistoi në konsultimin publik të Projektplanit Strategjik, përmes publikimit të tij *online* gjatë periudhës mars–maj 2020 si dhe sesionet e konsultimit të jashtëm me aktorët e jashtëm: organizatat e shoqërisë civile që bashkëpunojnë me Kuvendin, medien, institucionet e pavarura; ish-deputetët e Kuvendit

² Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik është një nga prioritetet bazë të Kuvendit, adresuar në rezultatet kryesore të projektit 4-vjeçar “Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar”, që financohet nga qeveria e Konfederatës Zvicerane. Përfutjesit kryesorë të këtij projekti janë Kuvendi i Shqipërisë dhe qytetarët shqiptarë. Partnerët zbatues të projektit janë organizata ndërqeveritare OSBE (prezenca në Shqipëri) dhe organizata jofitimprurëse NDI.

³ Carol Weiss, 1995:

<https://www.theoryofchange.org/what-is-theory-of-change/how-does-theory-of-change-work/>

⁴ Standardet lidhur me funksionimin e parlamenteve të vendosura nga Unioni Ndërparlamentar (IPU):

<https://www.ipu.org/our-impact/strong-parliaments/setting-standards>.

Faqe | 9466

⁵ Raportet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri; raportet e GRECO-s për Shqipërinë; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (UNCAC); Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara; raportet e SIGMA-s etj.

⁶ Raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë; rezolutat e Parlamentit Evropian për Shqipërinë; konkluzionet e Këshillit të Ministrave të BE-së dhe të Këshillit Evropian, relevante për Shqipërinë.

⁷ Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit BE–Shqipëri; Komiteti i Stabilizim-Asociimit BE–Shqipëri; nënkomiteti e Stabilizim-Asociimit BE–Shqipëri.



me përvojë të gjatë legislative si dhe me grupe të të rinjve⁸.

- Qasjen gjinore të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij, duke reflektuar parimet evropiane të integritimit gjinor, si dhe duke e harmonizuar me programin e veprimit “Për një parlament të ndjeshëm gjinor”, si dokumentin kuadër që do të udhëheqë punën e Kuvendit në aspektin e integritimit dhe barazisë gjinore.

II. PROFILI I KUVENDIT

Viti 2020 përkon me 100-vjetorin e parlamentarizmit shqiptar. Historia e parlamentarizmit shqiptar fillon më 21 janar 1920 me mbajtjen e Kongresit të Lushnjës dhe zgjedhjen e Këshillit Kombëtar. Zgjedhjet e para pluraliste pas rënies së sistemit totalitar u zhvilluan më 31 mars të vitit 1991.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Shqipëria është shtet unitar dhe republikë parlamentare. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit, që e ushtron në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij në Kuvend.

Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë. Si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin shqiptar, Kuvendi është organi më i lartë legjislativ që miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Kuvendi ushtron funksionin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit dhe monitoron institucionet e pavarura.

Kuvendi garanton interesat e të gjitha grupeve shoqërore në vendimarrjen që realizohet përmes dialogut politik dhe kompromisit. Kuvendi, në mënyrë të vazhdueshme, ka rritur nivelin e përfaqësimit ndaj elektoratit dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve duke qenë i hapur dhe transparent.

Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese, organizative, koordinuese dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij.

III. VIZIONI

Vizioni përshkruan synimin për të ardhmen e Kuvendit të Shqipërisë dhe shpreh gatishmërinë se

të gjitha veprimet duhet të zhvillohen në kuadër të arritjes së këtij vizioni. Vizioni i Kuvendit të Shqipërisë është:

“Kuvend përfaqësues, efektiv, eficient dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese.”

IV. MISIONI

Me qëllim përmbushjen e vizionit, deklarata e misionit të Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 2020–2025 është:

“Ligjëbërje cilësore dhe kontroll parlamentar i fortë, pranë qytetarëve për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integritetin evropian të Shqipërisë.”

V. VLERAT THEMELORE

Në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij Kuvendi i Shqipërisë udhëhiqet nga këto vlera themelore:

- përfaqësimi;
- kushtetutshmëria dhe ligjshmëria;
- llogaridhënia dhe gjtëhpërfshirja;
- barazia dhe mosdiskriminimi;
- transparencja;
- integriteti dhe etika;
- profesionalizmi dhe kompetenca;
- paaënësia politike⁹.

VI. FUSHAT PRIORITARE, QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

PRIORITETI I: Efektiviteti i ushtrimit të funksioneve përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës

Kuvendi i Shqipërisë gjatë ushtrimit të funksioneve të përcaktuara në Kushtetutë është përballur me pengesa dhe vështirësi që duhen

⁹ Neni 2, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës parashikojnë: “1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. 2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti”.

Neni 70, pika 1 e Kushtetutës parashikon: “Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues”.

Neni 107, pika 1 e Kushtetutës parashikon: “Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit”.

Neni 5, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikon: “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paaënësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”.

⁸ Komentet dhe sugjerimet e mbledhura nga procesi i konsultimit iu nënshtruan vlerësimit të grupit të punës dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre gjetën reflektim në Planin Strategjik dhe në Planin e Veprimit për zbatimin e tij, duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm të këtyre dy dokumenteve.



adresuar. Në ushtrim të funksionit ligjvënës duhet përmirësuar cilësia e projektligjeve të propozuara, duhet rritur numri i nismave të deputetëve dhe nismave nga zgjedhësit, si dhe duhet siguruar respektimi më i mirë i rregullave procedurale. Kontributi real i shoqërisë civile dhe i grupeve të interesit në procesin legjislativ duhet rritur.

Ushtrimi i kontrollit parlamentar me të gjitha mekanizmat e tij duhet përmirësuar në disa aspekte. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet kontrollit për zbatimin e ligjeve. Deputetët duhet të ndërgjegjësohen për përdorimin cilësor dhe sasior të këtyre mekanizmave. Në funksion të ushtrimit të kontrollit mbështetja e vazhdueshme nga Kuvendi ndaj institucioneve të pavarura është vlerësuar e domosdoshme, me qëllim rritjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të tyre nga ekzekutivi.

Në ushtrim të funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies duhet forcuar lidhja e deputetëve me zgjedhësit nëpërmjet vënies në eficiencë të plotë të zyrave të deputetëve në qarqe dhe përdorimit të mjeteve dhe mënyrave të tjera të komunikimit.

Ndërveprimi i platformave elektronike ekzistuese dhe integrimi i tyre në nivel institucional dhe ndërinstitutional do t'i shërbejë unifikimit të standardeve në funksion të procesit ligjvënës.

Qëllimi strategjik: Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare

Objektivat strategjikë:

1. Përmirësimi i punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare dhe seancat plenare, duke përfshirë aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Përmirësimi i mekanizmave dhe i praktikave të mbikëqyrjes parlamentare.

3. Forcimi i bashkëpunimit Kuvend-qeveri, Kuvend-shoqëri civile dhe grupe interesi.

4. Zbatimi efektiv i mekanizmit ndërinstitutional Kuvend-institucione të pavarura-ekzekutiv.

5. Përmirësimi i ndërveprimit deputet-qytetar në ushtrimin e funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve.

6. Përdorimi me efikasitet i teknologjisë së informacionit në përmirësimin e funksioneve të Kuvendit dhe punën në distancë.

PRIORITETI II: Roli i Kuvendit në proceset integruese dhe diplomacinë parlamentare

Kuvendi i Shqipërisë luan një rol thelbësor në procesin e integritetit evropian të vendit, duke i

garantuar procesit legjitimitetin e nevojshëm demokratik, si dhe kontrollin ligjor dhe politik.

Konsolidimi i mëtejshëm i demokracisë dhe parlamentarizmit në Shqipëri, si dhe sfidat e reja me të cilat do të përballlet Kuvendi pas hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në, e bëjnë të domosdoshëm përmirësimin e mëtejshëm të rolit të tij në procesin e integritetit evropian, me qëllim monitorimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, nga procesi i negociatave dhe i pranimit në BE.

Kuvendi përmes diplomacisë parlamentare luan rol të rëndësishëm në forcimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me shtetet e tjera, dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke kontribuar në rritjen e mirëkuptimit dhe forcimin e bashkëpunimit reciprok mes shteteve. Kuvendi do të forcojë më tej bashkëpunimin me Parlamentin Evropian dhe parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, me qëllim promovimin e procesit të integritetit evropian të vendit.

Qëllimi strategjik: Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian dhe i diplomacisë parlamentare.

Objektivat strategjikë:

1. Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Integritetit Evropian dhe Këshillat Kombëtar të Integritetit Evropian.

2. Forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit për kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve me acquis të BE-së.

3. Rritja e efektivitetit të monitorimit nga Kuvendi për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integritetit evropian të Shqipërisë.

4. Rritja e efektivitetit të diplomacisë parlamentare në funksion të integritetit evropian dhe zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe me parlamentet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

PRIORITETI III: Transparenca, pjesëmarrja dhe edukimi qytetar në veprimtarinë e Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë u siguron qytetarëve të drejtën e informimit dhe pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e tij, sipas legjislacionit në fuqi. Instrumentet që përdor Kuvendi në funksion të transparencës institucionale duhen përmirësuar në vazhdimësi.

Kuvendi duhet të rishikojë “Strategjinë e komunikimit” dhe të sigurojë monitorimin e zbatimit të saj në funksion të transparencës dhe



edukimit qytetar. Kjo Strategji duhet të përmbajë politika për përmirësimin e marrëdhënies së Kuvendit me medien. Në mënyrë të veçantë faqja zyrtare e internetit duhet të jetë lehtësisht e përdorshme dhe informacioni të pasqyrohet në mënyrën e duhur për publikun e gjerë, me qëllim arritjen e një parlamenti digjital dhe të hapur.

Kuvendi zhvillon aktivitete mbi edukimin qytetar, që duhet të jenë të mirëplanifikuara, të strukturuar dhe në përputhje me interesin e publikut. Për këtë arsye Kuvendi duhet të punojë për harmonizimin e standardizimit të formave të edukimit qytetar me format e reja dhe krijuese.

Kuvendi duhet të krijojë lehtësitë e nevojshme për të pasqyruar kontributin e shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit që dëshirojnë të jenë pjesëmarrës aktivë në vendimarrje.

Qëllimi strategjik: Rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit.

Objektivat strategjikë:

1. Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare.

2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe e angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e parlamentit.

3. Promovimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse me anë të teknologjisë së informacionit.

4. Përmirësimi i marrëdhënieve me medien për pasqyrimin real të veprimtarisë së Kuvendit.

PRIORITETI IV: Kuadri rregullator, burimet njerëzore dhe infrastruktura e Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duhet të ketë pavarësi të plotë organizative, funksionale e financiare. Në këtë aspekt sigurimi i pavarësisë financiare kërkon rishikimin e kuadrit ligjor.

Modernizimi i shërbimeve të Kuvendit për t'u përballuar me nevojat dhe sfidat e reja të kohës sjell domosdoshmërinë e reformimit të strukturës së shërbimeve, hartimit të një strategjie për zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm.

Nevoja e një standardi bashkëkohor të kërkimit parlamentar, bibliotekës dhe edukimit qytetar sjell domosdoshmërinë e krijimit të Institutit Parlamentar.

Hapësirat e pamjaftueshme për deputetët dhe administratën dhe zhvillimi i veprimtarisë parlamentare në dy godina të ndryshme sjellin

pengesa dhe vështirësi logjistike në zhvillimin e veprimtarisë normale të Kuvendit. Në këto kushte, lind nevoja për projektimin dhe ndërtimin e një godine të re, e cila do të ketë edhe sallën e re të seancave plenare.

Qëllimi strategjik: Përmirësimi i kuadrit rregullator, forcimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës.

Objektivat strategjikë:

1. Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Kuvendit.

2. Rritja e kapaciteteve të administratës, në përputhje me sfidat dhe kërkesat e reja.

3. Përmirësimi i menaxhimit dhe i komunikimit të brendshëm organizativ të administratës.

4. Rritja e efektivitetit dhe paanshmërisë në ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe edukuese nëpërmjet Institutit Parlamentar.

5. Përmirësimi i hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës me standarde të larta.

VII. Zbatimi dhe monitorimi

Plani Strategjik i Kuvendit, 2020–2025, është një proces në vazhdimësi, i cili duhet të monitorohet, të vlerësohet dhe, nëse është e nevojshme, të rishikohet me qëllim për ta përshtatur me zhvillimet e reja, si dhe për të siguruar eficiencën dhe qëndrueshmërinë e tij.

Plani Strategjik i Kuvendit shoqërohet nga Plani i Veprimit për zbatimin e tij (shtojca 1), që përmban aktivitetet konkrete për realizimin e secilit objektiv strategjik, të cilat do të realizohen gjatë periudhës 2020–2025. Për çdo aktivitet të parashikuar në Planin e Veprimit (124 aktivitete) janë përcaktuar treguesit e performancës, struktura përgjegjëse për zbatimin e tij, afati i realizimit dhe efekti financiar shtesë (nëse ka), sipas burimeve të financimit (buxheti i Kuvendit dhe/ose donatorët/partnerët).

Ndikimi i Planit Strategjik në përmirësimin e punës dhe zhvillimin e Kuvendit, si dhe progresi drejt arritjes së vizionit të Kuvendit do të varet nga zbatimi i plotë i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit do të monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve vjetore që Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit do t'i dërgojë Byrosë së Kuvendit.

Plani i Veprimit do të vlerësohet dhe rishikohet çdo vit për ta përshtatur me zhvillimet e reja. Rishikimi i Planit të Veprimit do të bëhet mbi



bazën e raporteve vjetore për zbatimin e tij, të cilat do të shërbejnë si burimi kryesor i të dhënave për vlerësimin dhe rishikimin e Planit të Veprimit.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke e vënë theksin te rëndësia e plotësimit menjëherë të vendeve të lira në Gjykatën e Lartë, me qëllim funksionalitetin e kësaj Gjykate, si dhe krijimin e kushteve ligjore për zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga mbledhja e anëtarëve të Gjykatës së Lartë sipas parashikimeve të nenit 7/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në drejtimin dhe kujdesin për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

Vlerëson:

- Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e shtatë vendeve të lira në Gjykatën e Lartë.

- Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në plotësimin e një numri të konsiderueshëm të vendeve të lira në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

- Punën e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për hartën e re gjyqësore, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e propozimit të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave sipas parashikimeve të nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

- Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për hartimin dhe miratimin e një serie aktesh nënligjore normative dhe rregullatorë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, si dhe rëndësinë e përmbylljes së paketës së plotë të këtyre akteve sa më parë.

- Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme.

- Analizat e kryera për shumë aspekte të sistemit gjyqësor, mbarëvajtjen e punës në gjykata dhe masat e marra në këtë drejtim.

- Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në propozimin dhe administrimin e buxhetit të vet dhe të gjykatave, si dhe nevojat përkatëse.

- Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes opinionëve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimit të tij.

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2020, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

- Zhvillimin e 87 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 654 vendimeve, prej të cilave 640 janë vendimmarrje me nismën e komisioneve të përhershme dhe 14 nga komisionet e përkohshme.

- Transparencën në vendimmarrje nëpërmjet publikimit të tyre në faqen zyrtare të institucionit.



- Miratimin e një pakete aktesh nënligjore, nëpërmjet të cilave nisi procesi i reformës së administratës gjyqësore, proces i cili pati si pikënisje rekrutimin e 86 nëpunësve gjyqësorë.

- Krijimin e njësisë së shërbimit ligjor në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, si një mekanizëm për të përshpejtuar evadimin e dosjeve gjyqësore.

- Emërimin në mënyrë të përkohshme të 4 këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë.

- Emërimin dhe caktimin në detyrë të 34 magistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës.

- Rritjen e numrit të kuotave në Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2020–2021, plotësimin me 40 kandidatë për magistratë në “profilin gjyqtar” dhe 25 kandidatë në profilin këshilltar dhe ndihmës ligjor, për të cilët u krye edhe verifikimi i kriterëve formale-ligjore, pasurisë dhe figurës.

- Finalizimin e propozimit të Hartës së re Gjyqësore, e cila i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë.

- Propozimin e ndryshimeve të kodeve të procedurave dhe ligjeve të paketës së reformës në drejtësi, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektshmërisë së gjyqësorit.

- Bashkëpunimin me organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, duke hartuar për llogari të KPK-së 72 raporte të aftësive profesionale dhe analizuar rreth 360 dosje gjyqësore.

- Plotësimin e paketës së akteve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe fillimin e procesit të vlerësimit periodik duke vlerësuar 30 gjyqtarë në përputhje me “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”.

- Miratimin e propozimit “Për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”, hartuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

- Zbatimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore ndaj gjyqtarëve, duke zhvilluar 3 procedime disiplinore, nga të cilat: një procedurë më objekt pezullimin dhe dy procedime disiplinore për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

- Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, KLGJ-ja trajtoi 629 kërkesa për caktimin e 874 gjyqtarëve, të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

- Hartimin e dy dokumenteve strategjike: Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor dhe rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me medien”.

- Zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke trajtuar 58 kërkesa për informacion, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

- Rritjen e kapaciteteve njerëzore duke trajnuar 19 punonjës të KLGJ-së dhe 220 gjyqtarë, në bashkëpunim me Shkollën e Magistraturës, ASPA-n, si dhe partnerët rajonale dhe ndërkombëtarë.

- Finalizimin e draftit për konsultim të Planit të ri Strategjik 2021–2023, i cili po i nënshtrohet një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent diskutimi me grupet e interesit.

- Përmirësimin e sistemeve dhe kapaciteteve aktuale të teknologjisë së informacionit, duke kryer 84 zhvillime të reja, të cilat i shërbejnë përmirësimit të punës si nga gjyqtarët, ashtu edhe nga stafi mbështetës në pamundësi për një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS).

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë Gjyqësor:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin gjyqësor.

2. T’i kushtojë rëndësi informimit të publikut për qasjen në drejtësi dhe mbarëvajtjes së marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun.

3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

4. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin gjyqësor, duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2021 i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër procesin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, me qëllim vënien në funksionalitet të plotë të saj.

2. Të plotësojë vendet vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Të formalizojë propozimin e përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë për riorganizimin e rretheve



gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, si dhe përmbylljen e paketës së plotë me akte nënligjore normative dhe rregullatore sipas përcaktimeve ligjore.

4. Të angazhohet në rritjen profesionale të gjyqtarëve dhe administratës së gjykatës nëpërmjet mundësive të vazhdueshme për zhvillimin profesional, duke bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën e Magjistraturës dhe ASPA-n, përkatësisht.

5. Të përshpejtojë ritmet e punës në vlerësimin vjetor të performancës së gjyqtarëve dhe personelit të administratës së gjykatës.

6. Të vijojë bashkëpunimin me organet e rivlerësimit kalimtar për përshpejtimin e përmbylljes së këtij procesi.

7. Të përmbyllë procesin e vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve, në përputhje me skemën e vlerësimit të gjyqtarëve.

8. Të angazhohet në propozime konkrete për përmirësime ligjore bazuar në përvojën e fituar dhe problematikën e dala përgjatë veprimtarisë së institucionit.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 14.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore, si dhe pezullimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhduesh të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë në vendosjen e masave disiplinore dhe procedimeve të tjera, sipas përcaktimeve ligjore, në funksion të rritjes së efikasitetit funksional për të dyja institucionet;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit të prokurorisë;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat për funksionimin eficient të sistemit të prokurorisë,

Vlerëson:

- Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për hartimin dhe miratimin e një serie aktesh nënligjore normative, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë prokurorët, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi;

- Veprimtarinë e Këshillit për plotësimin e vakumeve të krijuara në sistemin e drejtimit të prokurorëve si pasojë e shkarkimit të drejtuesve të prokurorëve gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;

- Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për rregullimin e disa aspekteve të veprimtarisë së prokurorëve, nëpërmjet miratimit të rregulloreve të ndryshme dhe vendimeve përkatëse;

- Punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme;

- Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë nëpërmjet opinionëve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimit të tij.

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2020, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

- Shqyrtimin dhe përmbylljen me vendimmarrje për një numër të konsiderueshëm çështjesh të rëndësishme, me karakter rregullator dhe normues,



përfshirë aktet specifike, lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimit të përkohshëm të prokurorëve, të ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, të transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele etj.;

- Hartimin dhe miratimin e rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e komisionit disiplinor dhe përcaktimin e procedurave të zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj prokurorëve”;

- Verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës;

- Miratimin e akteve nënligjore normative, në përmbushje të parashikimeve ligjore, për normimin, rregullimin dhe administrimin e karrierës së prokurorëve, si dhe veprimtarisë së KLP-së;

- Caktimin përkohësisht si drejtues të 19 prokurorëve në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe prokurorëve të Apelit;

- Miratimin e 49 raporteve për aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar prokurorë dhe vënien në dispozicion të KPK-së dhe ONM-së;

- Miratimin e 35 pozicioneve për prokurorë për t’u pranuar në programin fillestar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021;

- Përmbylljen e procedurave sipas ligjit dhe emërimin e 12 prokurorëve të rinj, të cilët tashmë janë pjesë e sistemit prokurorial;

- Dhënien e kontributit në hartimin dhe përshtatjen e kurrikulave për programin mësimor, për Programin e Formimit Fillestar të kancelarëve të prokurorëve;

- Dhënien e kontributit në hartimin dhe dërgimin e kontributit të katërt të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2020, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e përfaqësuesit si pjesë të kapitullit 23, të “Gjyqësorit dhe të drejtat themelore”;

- Hartimin e Strategjisë së Komunikimit, me fokus përmirësimin e komunikimit me publikun dhe institucionet, si dhe realizimin e transparencës përmes publikimit të vendimeve dhe akteve të tjera në faqen zyrtare të institucionit.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin e prokurorisë, veçanërisht në reduktimin e emërimeve të përkohshme.

2. Të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm me qëllim ndjekjen e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve.

3. Të vazhdojë t’i kushtojë rëndësi komunikimit me publikun për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

5. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin e prokurorisë, duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2021, kërkon nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

1. Vijimin e procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të bërë të mundur plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion, në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 6, datë 28.1.2021.

2. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje.

3. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët.

4. Përfundimin dhe miratimin e raporteve për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kancelarëve në detyrë në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

5. Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë.

6. Hartimin dhe miratimin në një afat sa më të shkurtër të rregullores për vlerësimin e punës së prokurorëve.



7. Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullores për pensionin e parakohshëm të prokurorëve, në mbështetje të pikës 4, të nenit 27, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8. Hartimin, miratimin dhe zbatimin e Rregullave (Kodit) për Etikën e prokurorëve.

9. Përgatitjen dhe miratimin e programit të përvitshëm për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve.

10. Angazhimin në dhënien e deklaratave publike në mbrojtje të prokurorëve të veçantë, kur gjykohet se e drejta e tyre njerëzore rrezikohet të shkelet për shkak të kryerjes së detyrës ose kur kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat.

11. Vijimin e dhënies së opinionëve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 187, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe zbatimin e ligjeve, që ngarkojnë me kompetenca këtë institucion;

Duke vlerësuar rolin e prokurorisë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në vend, në zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit;

Duke mbajtur parasysh rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Duke ritheksuar detyrimin e prokurorisë për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë, të

rregullt ligjor për të mbrojtur liritë personale dhe të drejtat e njeriut, për të mbrojtur e për të forcuar rendin juridik dhe për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

Duke ritheksuar përgjegjësitë e prokurorisë në zbatimin me sukses të reformës në drejtësinë penale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në luftimin e pastrimit të parave të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;

Duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm me organet ekzekutive ligjzbatuese, Kuvendin e Shqipërisë dhe organet e tjera homologe dhe organizatat e asistencës dhe ndihmës në raport me prokurorinë;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave, si bazë e nevojshme për të analizuar kriminalitetin, format dhe prirjet e tij, si dhe bazë shkencore për të hartuar, zbatuar, ndryshuar dhe vlerësuar politikën penale dhe efektivitetin e institucioneve të drejtësisë penale;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke vlerësuar kontributin e dhënë mes opinionëve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij;

Të ndërgjegjshëm për rolin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të integritetit evropian;

Duke mbajtur parasysh rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.6.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019”;

Bazuar në analizën e të dhënave për kriminalitetin në vend gjatë vitit 2020, të referuara në raportin e paraqitur, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2020:

- Koeficienti i kriminalitetit, sipas procedimeve penale të regjistruara, është 1072 për 100.000 banorë, në të njëjtën vlerë me vitin 2019.

- Grupet e veprave penale që zënë një përqindje më të madhe në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2020 janë: vjedhja e pasurisë (31,24 për qind) pasuar nga



veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike (26,46 për qind), veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës (6,28 për qind) dhe veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (4.88 për qind).

- Grupet e tjera të veprave penale zënë një përqindje më të vogël në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara, si: krimet kundër jetës të kryera me dashje (1,85 për qind); krimet kundër shëndetit të kryera me dashje (3,09 për qind); veprat penale e mashtrimet (2,25 për qind); shkatërrimi i pronës (4,10 për qind); veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet (1,08 për qind); falsifikimi i dokumenteve (2,70 për qind); krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (2,50 për qind); krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik (2,37 për qind); veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë (3,15 për qind) dhe veprat penale kundër drejtësisë (1,81 për qind).

- Për sa i përket gjinisë, raporti i të pandehurve ishte 97,86 për qind meshkuj dhe 2,14 për qind femra. Numri i procedimeve penale të femrave është ulur.

- Lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, në krahasim me vitin 2019, rezultoi ulje e numrit të çështjeve të përfunduara me 7,14 për qind të çështjeve të dërguara në gjykatë me 38,11 për qind; 22,62 për qind janë pushuar; 35,93 janë pezulluar dhe 3,34 për qind janë transferuar në prokuroritë kompetente. Numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 5,93 për qind

- Gjatë vitit 2020 janë dërguar në gjykatë për pushim 4647 çështje ose me rritje 53,16 për qind krahasuar me vitin 2019, prej të cilave janë pushuar për mungesë fakti 48,46 për qind;

- Prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar 150 shtetas shqiptarë ose të huaj dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tiranë të procedojë me heqjen e 201 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar. Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar 1106 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja;

- Janë ekzekutuar 1577 vendime për përgjime të autorizuar nga gjykata në hetimet paraprake, të zbatuara për 630 procedime penale. Është mundur interceptimi për 3535 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale;

- Janë filluar kryesisht 59 procedime penale nga ana e prokurorisë.

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi:

Rezolutën e tij të datës 18.6.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2019”, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5, të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017, “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”;

Rekomandimet e Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, të miratuara në zbatim të nenit 103, pika 3, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Raportin e ministres së Drejtësisë për mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë së rekomandimeve parësore të dhëna nga Këshilli i Ministrave, në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të nenit 103, pika 5, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në analizën e raportit, të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe në raportimin e ministres së Drejtësisë rezultoi, se:

- Janë miratuar udhëzime për zbatimin nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, si dhe për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

- Janë miratuar udhëzime të përgjithshme për rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm me synim garantimin e pavarësisë së prokurorit;

- Janë miratuar dy rregullore për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, në bashkëpunim me misionin EURALIUS V.

- Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, me synim rritjen e bashkëpunimit me institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) ka përgatitur dhe iniciuar



projektmarrëveshjen e bashkëpunimit “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, marrëveshje e nënshkruar nga drejtuesit e këtyre institucioneve në shkurt të vitit 2021.

- Është nënshkruar akti i koordinimit institucional “Për rritjen e eficiencës nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme”.

- Bashkëpunimi midis organit të prokurorisë dhe institucioneve agjencive ligjzbatuese është rritur;

- Prokuroria e Përgjithshme ka nxitur bashkëpunimin me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe ka kontribuar për të përfunduar projektregulloren “Për caktimin e rregullave për trajnimin fillestar për hetimin e personave të përzgjedhur si oficerë të Policisë Gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve të Policisë Gjyqësore”.

- Ka organizuar trajnime me pjesëmarrjen e prokurorëve me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, oficerëve të Policisë së Shtetit, strukturave hetimore të doganave dhe tatimeve, inspektorëve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

- Vijon të mbetet i ulët roli proaktiv i prokurorit për çështje të filluara kryesisht, veçanërisht në lidhje me veprat penale kundër korrupsionit, si dhe numri i rasteve të përdorimit të metodave speciale të hetimit.

- Lidhur me veprën penale të dhunës në familje, vihet re rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, por, sipas raportit të ministrisë së Drejtësisë, nuk konstatohet ashpërsimi i politikës penale nga gjykatat.

- Vlerësohet analiza e veprave penale, sipas strukturës së Kodit Penal e kryer nga Prokurori i Përgjithshëm në raportin e paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë, në veçanti politika penale dhe siguria publike, por nuk ka analizë të viktimave të veprave penale dhe të kostove të tyre.

Bazuar sa më sipër, për vitin 2021 Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë:

1. Të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

2. Të forcohet koordinimi dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, për rritjen më tej të eficiencës së veprimtarisë ndërinstitucionale dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF).

3. Të forcohen kapacitetet institucionale për rritjen e eficiencës në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre nëpërmjet vijimit të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, bashkërendimit dhe koordinimit me Këshillim e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas rregullave të përcaktuara në ligj.

4. Të standardizohen procedurat e funksionimit nga pikëpamja administrative për unifikimin e volumit të punës dhe normalizimin e veprimtarisë në prokurori nëpërmjet përgatitjes së një udhëzimi të përgjithshëm “Për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori”, me synim përcaktimin e normës e volumit të punës orientuese për prokurorët në sistemin e juridiksionit të përgjithshëm sipas standardeve evropiane.

5. Të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grup-vepra penale dhe të organizojë trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve, krahas trajnimeve vazhduese të prokurorëve bazuar në programin e Shkollës së Magjistraturës.



Bashkëpunimi dhe mbështetja e misionëve dhe projekteve ndërkombëtare që asistojnë prokurorinë është e mirëpritur.

6. Të përgatitet në një kohë sa më të shpejtë një manual për hetimet dhe ndjekjen penale të grupveprave të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të organizohen trajnime në këtë fushë me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit për një përgjigje më të mirë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen më të mirë të viktimave dhe në veçanti grave dhe fëmijëve, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me OSBE-në.

7. Të forcohet bashkërendimi, koordinimi dhe roli monitorues i Prokurorisë së Përgjithshme për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë, në përputhje me parashikimet ligjore, duke e vënë theksin te rritja e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe KLP-në në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore ose etike dhe adresimit të problemeve që hasen në prokuroritë e të gjithave niveleve.

8. Të miratohen projektudhëzimet e përgjithshme “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese përkatëse” dhe “Për krijimin dhe funksionimin e grupeve të hetimit për çështje të veçanta në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, punë që po kryhet në bashkëpunim me misionin EURALIUS V.

9. Të ndërmerren hapa konkretë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit, gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare.

10. Krahës statistikave që publikohen tashmë, të mbledhë, të përpunojë dhe të publikojë të dhëna për viktimat e veprave penale dhe kostot e krimit, për kriminalitetin e kryer nga të miturit, femrat, veprat penale me motive diskriminuese.

11. Të përshejtojë punën e nisur për identifikimin e problemeve në “sistemin e menaxhimit të çështjeve” (CAMS) dhe të marrë

masa konkrete të një sistemi funksional sipas nevojave të organit të prokurorisë dhe për të mundësuar digjitalizimin e informacionit.

12. Të nxitet dhe të bashkëpunohet për ngritjen e strukturave hetimore nga Policia e Shtetit sipas ligjit.

13. Të angazhohet për forcimin e kapaciteteve të analizës dhe studimeve për kriminalitetin, format e shfaqjes së tij, viktimat dhe kostot e kriminalitetit në vend dhe një analizë e tillë të bëhet pjesë e raportit vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 14.6.2021.

VENDIM
Nr. 349, datë 16.6.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR SHISHET ENËMATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për shishet enëmatëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1161, datë 13.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për shishet enëmatëse”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**RREGULLORE**
PËR SHISHET ENËMATËSE**KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat metrologjike ndaj shisheve enëmatëse që kontrollohen ligjërisht, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në to dhe metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për enët, të quajtura shishe të bëra prej qelqi ose prej ndonjë materiali tjetër, që kanë fortësi dhe qëndrueshmëri të tillë për të ofruar të njëjtat garanci metrologjike si qelqi, kur enë të tilla:

a) janë të taposura apo të projektuara për t'u taposur, që destinohen për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve;

b) kanë kapacitet nominal nga 0,05 litra deri në 5 litra, përfshirë këto dy vlera;

c) kanë karakteristika metrologjike (karakteristika të projektimit dhe uniformitet të prodhimit) të tilla që mund të përdoren si shishe matëse kur ato mbushen deri në një nivel specifik ose një përqindje të specifikuar të kapacitetit të tyre “deri në buzë” dhe përmbajtja e tyre mund të matet me një saktësi të mjaftueshme.

2. Enët që plotësojnë kriteret në pikën 1 të këtij neni, do të quhen shishe enëmatëse.

Neni 3
Vendosja në treg e shisheve enëmatëse

1. Vendosja në treg dhe përdorimi i shisheve si enëmatëse do të kryhet vetëm nëse ato plotësojnë kërkesat dhe testimet e vendosura në këtë rregullore, në lidhje me përcaktimin e volumit të tyre ose metodat me të cilat ato janë kontrolluar.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, shisheet, që janë në përputhje me kërkesat e pikës 1, nuk mund të refuzohen, të ndalohen apo të kufizohen.

KREU II
KËRKESAT METROLOGJIKE PËR
SHISHET SI ENËMATËSE**Neni 4**
Kapacitetet e shisheve

1. Shisheet enëmatëse karakterizohen nga kapacitetet vijuese, që gjithmonë do të përcaktohen në temperaturën 20 °C:

1.1 Kapaciteti nominal V_n është vëllimi që është shënuar në shishe; ky është vëllimi i lëngut që shishja konsiderohet të përmbajë kur mbushet në kushtet e përdorimit ashtu siç është destinuar;

1.2 Kapaciteti “deri në buzë” është vëllimi i lëngut që përmban kur mbushet deri në buzë;

1.3 Kapaciteti i vërtetë i shishes është vëllimi i lëngut që në fakt ajo përmban kur mbushet saktësisht në kushtet që i përputhen teorikisht kapacitetit nominal.

2. Kapaciteti aktual i shisheve enëmatëse kontrollohet duke përcaktuar sasinë e ujit në 20 °C që shishja në fakt e përmban kur mbushet deri në nivelin që teorikisht i korrespondon kapacitetit nominal.

3. Kapaciteti aktual i shisheve enëmatëse mund të kontrollohet dhe në mënyrë indirekte me një metodë të saktësisë ekuivalente.

Neni 5
Metodat e mbushjes

1. Shisheet enëmatëse do të mbushen në dy metoda:

a) në një nivel konstant;

b) në një boshllëk konstant.

2. Distanca ndërmjet nivelit teorik të mbushjes për kapacitetin nominal dhe nivelit “deri në buzë”, si dhe diferenca ndërmjet kapacitetit “deri në buzë” dhe asaj nominale, njohur si volum i zgjerimit apo boshllëkut, duhet të jetë konstant në masë të perceptueshme për të gjitha shisheet e të njëjtë lloj apo për të gjitha shisheet që janë prodhuar me të njëjtin dizajn.

Neni 6
Gabimet maksimale të lejuara

1. Gabimet maksimale të lejuara (pozitive ose negative) të shisheve enëmatëse në një temperaturë



prej 20 °C dhe nën kushtet e kontrollit, të përcaktuara në aneksin 1, ndërmjet kapacitetit aktual dhe kapacitetit nominal V_n do të jetë në përputhje me tabelën në vijim.

Kapaciteti nominal V_n në mililitra	Gabimi maksimal i lejuar	
	në % të V_n	në ml
nga 50 deri 100	-	3
nga 100 deri 200	3	-
nga 200 deri 300	-	6
nga 300 deri 500	2	-
nga 500 deri 1000	-	10
nga 1000 deri 5000	1	-

2. Gabimi maksimal i lejuar i kapacitetit të treguar “deri në buzë” të një shisheje do të jetë i njëjti si gabimi maksimal i lejuar për kapacitetin nominal korrespondues.

3. Në prodhimin e shisheve enëmatëse, shfrytëzimi sistematik i tolerancave është i ndaluar.

Neni 7

Konformiteti i shisheve enëmatëse

1. Shishet që plotësojnë kërkesat e kësaj rregulloreje mund të shënohen me shenjë e konformitetit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 8.

2. Forma dhe paraqitja grafike e shenjës së konformitetit të kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse duhet të jetë konform aneksit 2.

3. Shishet enëmatëse do t'i nënshtrohen kontrollit metrologjik, sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në anekset e saj.

Neni 8

Përgjegjësitë e prodhuesit të shisheve enëmatëse

1. Çdo prodhues i shisheve enëmatëse, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, duhet të aplikojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për miratimin e shenjës me anë të së cilës ai identifikohet.

2. Prodhuesi, nën përgjegjësinë e tij, vendos shenjë e konformitetit “3” e referuar në nenin 7, me anë të të cilit vërteton se shishet përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Shenja e referuar në pikën 2 duhet të ketë të paktën 3 mm lartësi.

Neni 9

Përgjegjësitë e organeve kompetente

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë do të miratojë shenjë e identifikimit të prodhuesit, e referuar në pikën 1, të nenit 8.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, pas miratimit të shenjës së identifikimit të prodhuesit, informon inspektoratin që mbulon fushën e metrologjisë brenda një muaji dhe e publikon në faqen zyrtare të DPM-së.

3. Inspektorati, që mbulon fushën e metrologjisë, do të kontrollojë që shishet enëmatëse janë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje duke marrë mostra në vendin e prodhimit ose, nëse kjo nuk është e mundur, në ambientet e importuesit ose agentit të tij të vendosur në Shqipëri.

4. Kontrolli statistikor i marrjes së mostrës të jetë në përputhje me metodat e pranuar të inspektimit të pranimi të cilësisë. Efektshmëria duhet të jetë e krahasueshme me metodën referencë, të specifikuar në aneksin 1.

5. Kjo rregullore nuk përjashton asnjë kontroll që mund të kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë gjatë tregtimit të shisheve enëmatëse.

KREU III

MBISHKRIMET DHE SHENJAT E VENDOSURA MBI SHISHET ENËMATËSE

Neni 10

Rregullat për vendosjen e mbishkrimeve në shishe enëmatëse

1. Të gjitha mbishkrimet mbi shishet enëmatëse duhet të vendosen në mënyrë që të mos shuhet, të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në kushte normale të paraqitjes.

2. Një shishe enëmatëse do të mbajë në një anë të saj, në fund ose në rrethin e fundit:

a) një mbishkrim tregues për kapacitetin nominal të saj në shkronja:

- të paktën 6 mm të larta nëse kapaciteti nominal është më i madh se 100 cl;

- 4 mm të larta në qoftë se është nga 100 cl e poshtë deri 20 cl (pa përfshirë atë);



- 3 mm të larta në qoftë se ai nuk është më i madh se 20 cl, të ndjekur nga simboli i njësisë së matjes së përdorur;

b) shenjën e identifikimit të prodhuesit, e përshkruar në pikën 1, të nenit 8;

c) shenjën “3” e përshkruar në pikën 2 dhe 3, të nenit 8.

3. Një shishe enëmatëse do të mbajë në fund ose në rrethin e fundit, në përputhje me metodën ose metodat e mbushjes për të cilën është ideuar:

a) një mbishkrim tregues për kapacitetin “deri në buzë”, të shprehur në centilitra dhe të pandjekura nga simboli cl. Madhësia e mbishkrimit duhet të jetë e njëjtë me madhësinë e mbishkrimit për kapacitetin nominal;

b) dhe/ose një mbishkrim tregues në milimetra të distancës nga niveli “deri në buzë” deri te niveli i mbushjes që i përket kapacitetit nominal, i ndjekur nga simboli mm.

4. Tregues të tjerë mund të paraqiten në shishe enëmatëse, por ato nuk duhet të krijojnë konfuzion me treguesit kryesorë.

Aneks nr. 1

METODA REFERUESE PËR KONTROLLIN STATISTIKOR ME MOSTRA TË SHISHEVE ENËMATËSE

Ky aneks paraqet procedurat për kontrollin statistikor të shisheve enëmatëse ligjërisht të kontrolluara.

1. Metoda e marrjes së mostrave

Partia e kontrolluar duhet të përfshijë shishe enëmatëse të të njëjtë dizajn dhe të të njëjtë prodhim, të përcaktuar në prodhimin për një orë.

Nëse rezultati i kontrollit të një partie, që i korrespondon prodhimit orar nuk është i kënaqshëm, mund të kryhet një test i dytë i bazuar në një mostër tjetër të zgjedhur prej një partie që i korrespondon një periudhe kohe më të gjatë prodhimi ose mund të kontrollohen rezultatet e regjistrimeve të kartave të kontrollit të prodhuesit.

Numri i shisheve enëmatëse që përbën mostrën do të jetë 35 ose 40, në varësi të metodës së zgjedhur, që është metoda e devijimit standard dhe metoda e diapazonit mesatar.

2. Matja e kapacitetit të shisheve enëmatëse që përbëjnë mostrën

Shishe enëmatëse do të peshohen bosh, pastaj të mbushura me ujë me densitet të njohur në 20 °C, deri në nivelin e mbushjes përkatësisht me metodën e kontrollit të përdorur dhe ato pastaj do të peshohen plot.

Kontrolli do të kryhet me instrumente matëse të përshtatshme dhe të verifikuara nga organet përkatëse të DPM-së ose personat juridikë të autorizuar për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara dhe që mbajnë shenja të vlefshme që vërtetojnë këtë verifikim.

Gabimi në matjen e kapacitetit nuk mund të jetë më e madhe se një e pesta e gabimit maksimal të lejueshëm që i korrespondon kapacitetit nominal të shisheve enëmatëse.

Mesatarja e kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse të matura do të llogaritet dhe pastaj të vlerësohet me një nga metodat statistikore në vijim:

3. Kontrolli i kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në bazë të vlerësimit të mesatares së kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në një mostër duke përdorur metodën e devijimit standard

Merret një mostër çfarëdo prej 35 shisheve enëmatëse. Kapacitetet aktuale xi të shisheve enëmatëse në mostër do të maten të gjitha.

Llogarisni si vijon:

1. Vlerën mesatare $\bar{x}$ të kapaciteteve aktuale xi të shisheve enëmatëse në një mostër;

2. Devijimin standard të vlerësuar “s” të kapaciteteve aktuale xi të shisheve enëmatëse në parti;

3. Kufirin e sipërm të lejuar T_s : shuma e kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti;

4. Kufirin e poshtëm të lejuar T_i : diferenca ndërmjet kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti;

Partia do të deklarohet që plotëson kërkesat ndaj kapacitetit aktual nëse ajo plotëson njëkohësisht tri kriteret e pranimit që vijnë:

$$\bar{x} + k \cdot s \leq T_s$$

$$\bar{x} - k \cdot s \geq T_i$$

$$s \leq F(T_s - T_i)$$



ku: $k = 1.57$

$F = 0.266$

Llogaritjet:

1. Vlera mesatare e $\bar{x}$ kapaciteteve aktuale xi të shisheve enëmatëse në një mostër:

- Shuma e 35 matjeve të kapacitetit aktual është:

$$x_i = \sum x_i$$

$$\bar{x} = \frac{\sum x_i}{35}$$

- Vlera mesatare e 35 matjeve është:

- Shuma e katrorëve të 35 matjeve është: $\sum x_i^2$

- Katrori i shumës së 35 matjeve është:

$$(\sum x_i)^2, \text{ pastaj } \frac{(\sum x_i)^2}{35}$$

- Shuma e korrigjuar është:

$$SC = \sum x_i^2 - \frac{1}{35}(\sum x_i)^2$$

$$v = \frac{SC}{34}$$

- Varianca e llogaritur:

Devijimi standard “s” i llogaritur është: $s = \sqrt{v}$

2. Kontrolli i kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse, në bazë të vlerësimit të mesatares së kapaciteteve aktuale të shisheve në një mostër, duke përdorur metodën e diapazonit mesatar

Merret një mostër çfarëdo prej 40 shishesh enëmatëse. Do të maten kapacitetet aktuale xi të shisheve enëmatëse në mostër.

Llogarisni si vijon:

1. Vlerën mesatare $\bar{x}$ të kapaciteteve aktuale x të shisheve enëmatëse në një mostër;

2. Diapazonin mesatar $\bar{R}$ të kapaciteteve aktuale xi të shisheve enëmatëse në një mostër;

3. Kufirin e sipërm të lejuar T_s , shumën e kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti;

4. Kufirin e poshtëm të lejuar T_i , diferenca ndërmjet kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti.

Partia do të deklarohet që plotëson kërkesat ndaj kapacitetit aktual nëse ajo përmbush njëkohësisht të tria kërkesat e pranimit që vijojnë:

$$\bar{x} + k' \cdot \bar{R} \leq T_s$$

$$\bar{x} + k' \cdot \bar{R} \geq T_i$$

$$\bar{R} \leq F'(T_s - T_i)$$

ku: $k' = 0,668$

$F' = 0,628$

Llogaritjet:

1. Vlera mesatare e $\bar{x}$ kapaciteteve aktuale xi të shisheve enëmatëse në një mostër

Llogaritjet si vijon:

- Shuma e 40 matjeve të kapaciteteve aktuale xi

sipas formulës: $\sum x_i$

- Vlera mesatare e këtyre 40 matjeve sipas

formulës: $\bar{x} = \frac{\sum x_i}{40}$

2. Rangu (diapazoni) mesatar $\bar{R}$ të kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në një mostër.

Ndani mostrën sipas radhës kronologjike të zgjedhjes në tetë nënmostra prej pesë shishesh enëmatëse secila.

Llogaritjet si vijon:

- Diapazoni i secilës nënmostër, d.m.th. diferenca midis kapacitetit aktual më të madh dhe më të vogël të pesë shisheve enëmatëse në nënmostër; kështu merren tetë diapazone: $R_1, R_2, \dots, R_8$;

- Shuma e diapazoneve e tetë nënmostrave:

$$\sum R_i = R_1 + R_2 + \dots + R_8$$

- Diapazoni mesatar $\bar{R}$ llogaritet me formulën:

$$\bar{R} = \frac{\sum R_i}{8}$$



Aneks nr. 2

SHENJA E KONFORMITETIT

Shenja e KE-së “3” e konformitetit të kapaciteteve aktuale të shisheve me kërkesat e specifikuar në këtë rregullore



Shenja është një shkronjë “Epsilon” simetrikisht e rrotulluar në aksin vertikal.

VENDIM

Nr. 350, datë 16.6.2021

**PËR KONSTATIMIN E PËRFUNDIMIT
TË MANDATIT TË ANËTARIT TË
BORDIT DREJTUES TË AUTORITETIT
RRUGOR SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 4, 8, pika 2, shkronja “b” dhe 9, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, si dhe të pikës 2, të kreut III, të vendimit nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e mënyrës së organizimit, strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Konstatimin e përfundimit të mandatit të z. Elton Haxhi si anëtar i Bordit Drejtues të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 351, datë 16.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ITINERARE
KËMBËSORËSH ME PISTË VRAPIMI
DHE BIÇIKLETASH NË PARKUN E
LIQENIT ARTIFICIAL”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Itinerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe biçikletash në Parkun e Liqenit Artificial”, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë 124 169 229 (njëqind e njëzet e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 124 169 229 (njëqind e njëzet e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.



7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të

miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ITINERARE KËMBËSORËSH ME PISTË VRAPIMI DHE BIÇIKLETASH NË PARKUN E LIQENIT ARTIFICIAL"

Nr.	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truall i prekur (m ²)	Çmimi truall lek/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	B.P. Peti, Pasholli ; Guraja	Truall	8280	1/461	3,750.00	158.00	29543	4,667,794	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
2	B.P. Caushi , Kuci, Bakalli	Truall	8280	1/463	3,750.00	304.00	29543	8,981,072	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
3	B.P. Brajha, Dorda, Blushi, Opingari, Mija, Sahko, Brajha dhe Peti	Truall	8280	1/394	3,934.60	24.00	29543	709,032	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
6	B.P. Brajha dhe Muhaxhiri	Truall	8280	1/419	239.00	11.00	29543	324,973	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
7	Edmond Brajha	Truall	8280	1/418	468.60	128.00	29543	3,781,504	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
8	Alush Brajha	Truall	8280	1/416	468.60	129.00	29543	3,811,047	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
9	Malq Brajha	Truall	8280	1/415	468.60	82.00	29543	2,422,526	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
10	B.P. Brajha dhe Xibri	Truall	8280	1/73	3,750.00	328.00	29543	9,690,104	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
11	Vath Mehmet Brari	Truall	8280	1/79	760.00	30.00	29543	886,290	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Sipas shkresës nr. 243, datë 26.4.2011 bëhet regjistrimi i inventarizimit për pasuritë trashëgimore në emër të debitorëve. E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i rregullt në sistemin hipotekor. Shkresë përbarimi ku kuf. pasuria në bazë të vendimit të gjykatës nr. 8370, datë 3.11.2015, ardhur nga "Adrogrup".
12	Rukije Xibri	Truall	8280	1/388	728.70	74.00	29543	2,186,182	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
13	Dylbere Xibri	Truall	8280	1/389	728.80	72.00	29543	2,127,096	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
14	B.P. Dardha, Duraku dhe Xibri	Truall	8280	1/390	729.00	71.00	29543	2,097,553	Konfirmim nga ASHK me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
15	Selman Xibri	Truall	8280	1/391	728.60	91.00	29543	2,688,413	Konfirmim nga ASHK me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
16	Kujtim Xibri	Truall	8280	1/392	728.70	134.00	29543	3,958,762	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
17	Rexhep Brajha	Truall	8280	1/421	346.60	105.00	29543	3,102,015	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
18	Shyqri Reshit Brajha	Truall	8280	1/417	468.60	123.00	29543	3,633,789	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
19	Elona Sefer Baçe	Truall	8280	1/103	1,386.00	81.00	29543	2,392,983	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Pasuria është në proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë; C-K. Shkëmbimi nr. 1677/653, datë 11.11.20160; E- Pasuria është në proces gjyqësor në Gj. L. nr. regj. 719, dt. 17.2.2016, nr. 1261, regj. datë 10.3.2016.
20	B.P. Peti	Truall	8280	1/102	5,500.00	125.00	29543	3,692,875	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
22	B.P. Gjini	Truall	8280	1/405	2,945.00	19.00	29543	561,317	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
26	Ymer Brari	Truall	8280	1/378	382.00	31.00	29543	915,833	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
27	Ymer Brari	Truall	8280	1/379	322.00	50.00	29543	1,477,150	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
28	Majlinda Atuf Kotorri	Truall	8280	1/376	765.00	13.00	29543	384,059	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
29	B.P. Alla, Simoni	Truall	8280	1/375	3,570.00	223.00	29543	6,588,089	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
30	B.P. Alla	Truall	8280	1/377	765.00	25.00	29543	738,575	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Urdhër korrigjimi i emrit.
31	B.P. Peti	Truall	8280	1/435	2,918.00	171.00	29543	5,051,853	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.
34	B.P. Xhabrahimi, Peti, Sina	Shesh	8280	1/442	5,600.00	111.00	29543	3,279,273	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Në bazë të shkresës se Z. Përbarimit Tiranë nr. 3469 prot., date 21.5.2004, vihet sekuestro për debit. Mehmet Peti.



36	B.P. Brari, Stafa	Truall	8280	1/48	1,450.00	73.00	29543	2,156,639	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
37	B.P. Brari, Kasa, Brari	Truall	8280	1/47	1,600.00	10.00	29543	295,430	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
38	Hamid Hajdar Brari	Truall	8280	1/60	825.00	32.00	29543	945,376	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
39	Ymer Brari	Truall	8280	1/50	1,500.00	69.00	29543	2,038,467	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor.
42	Caje-Hoxha	Truall	8280	1/71	3,000.00	119.00	29543	3,515,617	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
43	Shaban Brari	Truall	8280	1/78	900.00	40.00	29543	1,181,720	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Sipas shkresës nr. 243, dt. 26.4.2011, bëhet regjistrimi i inventarizimit për pasuritë e trashëgimtarëve në emër të debitorëve. Regjistrohet kërkesë padia me v. gjyq; E- Deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor; Pronari ka një ndërtim pa leje.
47	B.P. Peti; Xhabrahimi; Sina	Shesh	8280	1/438	400.00	20.00	29543	590,860	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020. Në bazë të zyrës së përbarimit nr. 3469, dt. 21.5.2004, vihet në sekuestro për debit prona e Mehmet Peti.
49	Gazmend Ramazan Shkodra	Truall	8280	1/406	700.00	67.00	29543	1,979,381	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
50	B.P. Llapashtica dhe Gjika	Truall	8280	2/98	4,000.00	144.00	29543	4,254,192	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
52	B.P. Peti, Hoxha, Shkreta, Krasniqi (Peti), Shera (Peti)	Truall	8280	1/467	6,400.00	529.00	29543	15,628,247	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresën nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020.
53	B.P. Tresa, Hidri, Demneri, Llulla, Cufi (Dyli), Oruci, Gega, Kumi	Truall	8280	1/450	2,026.00	387.00	29543	11,433,141	Konfirmim nga ASHK-ja me shkresat nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020. Vendoset sekuestro konservative mbi pasurinë me shkresën nr. 28900, datë 28.7.2017, të ZVRPP Tiranë, për pjesën takuese të Albano Xhavit Tresa.
Total						4203		124,169,229	

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprahe të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ASHK Tiranë nr. prot. 10470/2, datë 29.6.2020 dhe nr. prot. 10470/4, datë 1.12.2020.

VENDIM Nr. 352, datë 16.6.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “PËR NDËRTIM, PËRMIRËSIM, SHFRYTËZIM, MIRËMBAJTJE TË AUTOSTRADËS ‘MILOT – MORINË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Për ndërtim, përmirësim, shfrytëzim, mirëmbajtje të autostradës ‘Milot – Morinë’”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 440 031 (një milion e katërqind e dyzet mijë e tridhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 440 031 (një milion e katërqind e dyzet mijë e tridhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.



9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kukës, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara, në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kukës, të pezullojë të gjitha transaksionet

me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I NYJAVE DHE RRUGËVE LIDHËSE NË AUTOSTRADËN KALIMASH – MORINË”

Nr.	Pronari			Z. kad.	Fshati	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Volumi	Shpronësimi				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri							Faqja	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	
1	RASIM	ABDULLA	ABDULLAH	2724	Morinë	181/4	arë	850	5	40	13	132	1716	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	NAIM	ABDULLA	ABDULLAH	2724	Morinë	181/2	arë	1687	5	37	170	132	22440	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
3	ABAZ	HALIT	DURAKU	2724	Morinë	180/14	arë	1104	6	6	16	132	2112	Konf. nr. 112 prot. datë 14.1.2021
4	RASIM	ABDULLA	REXHA	2724	Morinë	59/17	arë	780	3	56	116	132	15312	Urdhër kufizimi nr. 198, datë 14.11.2016
5	RAMADAN	SKENDER	SYLA	2724	Morinë	102	arë	10500	1	134	550	132	72600	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	ZENEL RAZE AHMET SHKELZEN BAJRIJE SERVETE	SALI DIN SALI SALI SALI	GROSHA GROSHA GROSHA GROSHA GROSHA (Grosha) SHEHU	1115	Bardhoci Ri	54/47	arë	5002	2	23	156	132	20592	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	BEQIR SONILA	SHEFQET FATMIR	DEMA DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/112	arë	1952	4	156	356	132	46992	Në favor të Alfa Bank
8	BEQIR SONILA	SHEFQET FATMIR	DEMA DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/111	truall	4650	4	155	170	203	34510	Në favor të Alfa Bank
9	BEQIR SONILA	SHEFQET FATMIR	DEMA DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/113	arë	6270	4	157	77	132	10164	Në favor të Alfa Bank
10	YMER	BILAL	DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/66	arë	1487	2	210	112	132	14784	Kufizim sipas urdhrit
11	ILMI	BILAL	DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/65	arë	1486	2	200	508	132	67056	Kufizim sipas urdhrit
12	ABEDIN	BILAL	DEMA	1115	Bardhoci Ri	54/64	arë	1487	2	207	27	132	3564	Kufizim sipas urdhrit
13	BAFTIJE NAZMIJE	RAM RAM	SHEHU MATMUJA	1115	Bardhoci Ri	83/1	arë	1968	3	110	31	132	4092	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	JAKUP	MAHMUT	GROSHA	1115	Bardhoci Ri	83/51	arë	2728	4	86	250	132	33000	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	MUHARREM	SINAN	GERMIZI	1115	Bardhoci Ri	83/4	arë	3240	2	4	304	132	40128	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	JAHIR	SINAN	GROSHA	1115	Bardhoci Ri	83/5	arë	1552	3	120	49	132	6468	Kufizim nr. 223, 16.10.2020
17	QEMAL	RAKIP	GROSHA	1115	Bardhoci Ri	83/6	arë	1550	3	102	7	132	924	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	QEMAL	RAKIP	GROSHA	1115	Bardhoci Ri	83/58	arë	1240	4	105	143	132	18876	Konf. nr. 99 prot., datë 13.01.2021
19	SHANE RASIM ENVER SABRIJE VJOLLCA	HASAN AVDI AVDI AVDI	DEMA DEMA DEMA (DEMA) BORIÇI (DEMA) KERXHALIU	1115	Bardhoci Ri	83/54	arë	2750	4	89	12	132	1584	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
20	BAFTIJE NAZMIJE	RAM RAM	SHEHU MATMUJA	1115	Bardhoci Ri	83/7	arë	4125	3	109	9	132	1188	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	RASIM	SHABAN	GERMIZI	1115	Bardhoci Ri	54/19	arë	2502	3	39	103	132	13596	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	MUSLI	ZYLFI	GERMIZI	1115	Bardhoci Ri	54/21	arë	2000	3	71	4	132	528	Kufizim sipas urdhrit
23	VEHAP	HASAN	ADEMI	1114	Bardhoci Ri	17/17	arë	1600	2	46	86	132	11352	Kufizim sipas urdhrit
24	VAID	SHUKRI	ADEMAJ	1114	Bardhoci Ri	17/13	arë	1428	2	52	168	132	22176	Kufizohet sipas urdhrit
25	MYRTEZA	VELI	ADEMAJ	1114	Bardhoci Ri	22/148	arë	2844	4	81	130	132	17160	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
26	DERVISH	RASIM	DIDA	2912	Përbreg	135/41	arë	2492	1	82	80	132	10560	Kufizim sipas urdhrit
27	QAMIL	RASIM	DIDA	2912	Përbreg	135/32	arë	1750	2	89	234	132	30888	kufizim sipas urdhrit
28	AJET	XHAHER	DIDA	2912	Përbreg	135/33	arë	1556.25	2	84	61	132	8052	kufizim sipas urdhrit
29	RAKIP	SINAN	MATMUJA	2912	Përbreg	135/34	arë	1140	2	51	57	132	7524	kufizim sipas urdhrit
30	ISUF	BERAM	MATMUJA	2912	Përbreg	135/35	arë	727	2	63	29	132	3828	kufizim sipas urdhrit
31	JEMIN	MYFTAR	HALLACI	2912	Përbreg	304/2/27	arë	1785	2	202	52	132	6864	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
32	ISUF	BAJRAM	MATMUJA	1176	Breglumë	110/27	arë	1100	1	141	32	132	4224	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
33	XHAHER	RAMIZ	MATMUJA	1176	Breglumë	110/28	arë	1500	2	127	108	132	14256	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
34	DAN	RAMIZ	MATMUJA	1176	Breglumë	110/29	arë	1500	2	85	138	132	18216	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016



35	ZENEL	ARIF	MATMUJA	1176	Breglumë	110/30	arë	2975	2	118	698	132	92136	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
36	DAN	RAMIZ	MATMUJA	1176	Breglumë	110/1	arë	3375	2	6	112	132	14784	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
37	XHAHER	RAMIZ	MATMUJA	1176	Breglumë	110/31	arë	1500	1	250	500	132	66000	Urdhër kufizimi nr. 165 datë 10.10.2016
38	Bashkpronaret SABRIJE BLERIM VALBONA ZARIFE BAFTI	BESNIK BESNIK BESNIK BESNIK BESNIK	BELULI BELULI BELULI BELULI BELULI	1176	Breglumë	110/10	arë	1800	2	131	76	132	10032	Kufizohet sipas urdhrir nr. 166, 10.10.2016
39	KADRI	HYSEN	MATMUJA	1176	Breglumë	110/4	arë	1425	2	5	325	132	42900	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
40	ZENEL	ARIF	MATMUJA	1176	Breglumë	110/3	arë	9275	2	11	668	132	88176	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
41	Bashkpronaret HAJRIJE SAFET LAZIME ALTIN ILMI KUJTIME LEONARD	BAJRAM VELI JASHAR SAFET SAFET SAFET SAFET	MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA	1176	Breglumë	110/2	arë	1125	2	139	339	132	44748	Urdhër kufizimi nr. 165, datë 10.10.2016
42	AVNI	TASIM	MATMUJA	1176	Breglumë	110/26	arë	1100	1	140	9	132	1188	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	XHEMALI XHEMILE AZEM XHEVRRIJE FERIT SHANI AJDIN SPAHE GYJLE	RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM RRAHIM	MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA MATMUJA	1176	Breglumë	110/25	arë	1215	2	130	153	132	20196	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	AVNI	TASIM	MATMUJA	1176	Breglumë	110/24	arë	1300	1	139	186	132	24552	Konfirmuar nga ASHK-ja
45	ISUF	BAJRAM	MATMUJA	1176	Breglumë	110/23	arë	1400	1	138	230	132	30360	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
46	RAKIP	SINAN	MATMUJA	1176	Breglumë	110/22	arë	1196	2	163	180	132	23760	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021
47	HAZIR	QAZIM	DURAKU	1176	Breglumë	110/21	arë	1850	1	225	507	132	66924	Konf. nr. 1158, datë 24.6.2019, kufizim hipotekor
48	AJET	XHAHER	DIDA	1176	Breglumë	110/20	arë	2200	2	2	828	132	109296	Konf. nga ASHK-ja Sekuestro konservative nga përmbartimi me nr. 571 rep., datë 18.12.2009, Fatime Matmuja, Xhemile Matmuja, Azem Matmuja, Xevrije Matmuja, Freit Matmuja, Shani Mtmuja, Ajdin Matmuja, Spahe Matmuja, Gjyle Matmuja.
49	MALIQ	FEZ	HALILAJ	3425	Shtiqen	1417	arë	1482	6	167	141	132	18612	Konfirmuar nga ASHK-ja, "Ka diferencë fakt-dok." ka ndërtim të paligjshëm.
50	MEHMET	NJAZI	HOXHA	3425	Shtiqen	1578	arë	3933	7	78	176	132	23232	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021.
51	PETRIT	RASIM	ORUÇI	1543	Drinas	211/2	truall	480	1	132	195	203	39585	Kufizim sipas VKM-së 481, 3.6.2015.
52	SHEFQET	MET	TODAJ	2759	Myç – Mamëz	5	arë	7900	1	5	1032	132	136224	Konf. nr. 99 prot., datë 13.1.2021.
SHUMA TOTALE											10713		1,440,031	



VENDIMI
Nr. 353, datë 16.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM I
RRUGËS ‘ALLAMANI’, FUSHË-KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Allamani’, Fushë-Krujë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 918 241 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 918 241 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar i Bashkisë Krujë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2021.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Krujë.

8. Bashkia Krujë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Krujë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Krujë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Krujë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Krujë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Allamani’, Fushë-Krujë”

Nr.	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Shënime sqaruese
1	Irbana Fatbardh Ziri	Truall	1664	1/398	400	328.53	2795	918,241	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale paraprake								918,241	

Shënim.

1. Vlerësimi i pasurisë së llojit “truall”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.



VENDIM

Nr. 354, datë 16.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËR PROJEKTIMIN,
NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
RRUGËS PORTI I JAHTVE – BYPASS
ORIKUM – DUKAT
(URA E SHËN ELIZËS)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës Porti i Jahtve – Bypass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 3 858 048 (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyzet e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 858 048 (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyzet e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2021, i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E RRUGËS PORTI I JAHTEVE – BYPASS ORIKUM – DUKAT (URA E SHËN ELIZËS)”

Nr.	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë														Vlera totale (lekë)	SHËNIME					
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronë sim tokë “truall”			Shpronësim tokë “pyll”			Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jobanimi				Ndërtesë total				
								Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)				Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. ndërt. konf. nga ZVRPP-ja (m²)	Çmimi mes. sh./blerjeve sipas ZVRPP-së (l/m²)				Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP- ja (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP- ja (m²)
1	HALO		FISTI(DANAJ)	1569	192/1	arë	2400	181.3	204	36985.2													36985.2	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
2	ARIZ		JAZOJ	1569	195/17	arë	14000	953.4	204	194493.6													194493.6	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
3	BEQIR		JAZOJ	1569	195/16	arë	6000	400.8	204	81763.2													81763.2	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
4	QAZIM	MUHARËM	NELO	1569	280/8	arë	1520	256.6	204	52346.4													52346.4	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
5	VEXHI	MUHARËM	NELO	1569	280/5	arë	4200	684.2	204	139576.8													139576.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
6	MEHMET MEXHAT		MEHILLI MEHILLI	1569	280/4	arë	750	144.3	204	29437.2													29437.2	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
7	FIRJAN	AMET	MEHILLAJ	1569	280/3	arë	750	151	204	30804													30804	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
8	QANI		MEHILLI	1569	280/2	arë	750	122.2	204	24928.8													24928.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
9	BEJKO		MEHILLAJ	1569	280/1	arë	750	261.5	204	53346													53346	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
10	TAJAR		KUTELAJ	1569	307/4	arë	5500	652.2	204	133048.8													133048.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
11	BEJKO		MEHILLAJ	1569	301/5	arë	7650	253.2	204	51652.8													51652.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
12	XHEBRO		BEDINI	1569	307/3	arë	4780	583.7	204	119074.8													119074.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
13	ZENEL		BEDINI	1569	307/2	arë	4780	433.4	204	88413.6													88413.6	Konfirmuar nga ASHK Vlorë				
14	FEJZI		KUTELAJ	1569	307/1	arë	8550	1881.4	204	383805.6													383805.6	Konfirmuar nga				



																							ASHK Vlorë
15	METE		KUTELI	1569	359/2	arë	13500	612.6	204	124970.4												124970.4	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
16	FATOSH		MEHILLI	1569	352/1	arë	3800	127.2	204	25948.8												25948.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
17	IZET		MEHILLI	1569	352/2	arë	2400	156.2	204	31864.8												31864.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
18	DITURI KRENAR DIANA ALBANA AUREL		MEHILLAJ MEHILLAJ CIPA BRAIMILO MEHILLAJ	1569	352/3	arë	4500	680.4	204	138801.6												138801.6	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
19	QEMAL		MEHILLI	1569	352/4	arë	3500	2280	204	465120												465120	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
20	METE		BOZHANI	1569	362/6	arë	19600	835	204	170340												170340	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
21	LEFTER		BOZHANI	1569	362/5	arë	9350	1123.1	204	229112.4												229112.4	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
22	LAVDOS H	NEIM	DULE	1569	360/12	arë	15840	2097.2	204	427828.8												427828.8	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
23	RUSHIT		CELO	1569	360/11	arë	9500	2006.3	204	409285.2												409285.2	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
24	RUSHIT		CELO	1569	410/7	arë	5500	695.1	204	141800.4												141800.4	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
25	QEMAL		MEHILLI	1569	410/3	arë	2500	135.4	204	27621.6												27621.6	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
26	ARMAND	CANO	MEHILLAJ	1569	410/1	arë	540	74.6	204	15218.4												15218.4	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
27	IZET		MEHILLI	1569	410/5	arë	1800	151	204	30804												30804	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
28	DITURI KRENAR DIANA ALBANA AUREL		MEHILLAJ MEHILLAJ CIPA BRAIMILO MEHILLAJ	1569	410/4	arë	3300	156.5	204	31926												31926	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
	SHUMA									3858048												3858048	Konfirmuar nga ASHK Vlorë

**VENDIM****Nr. 355, datë 16.6.2021**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI “SHITESË
E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË
UJIT TË PIJSHËM BOVILLË, ME 1 800
l/sek, NË FAZËN E DYTË TË
ZBATIMIT, ME 1 200 l/sek”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë, me 1 800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit, me 1 200 l/sek”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

3. Pronarët të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 11 056 007.60 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 056 007.60 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2021 të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2021 të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

8. Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Ujësjetllës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë – Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SHITESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM BOVILLË, ME 1 800 l/sek, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT, ME 1 200 l/sek”

Nr	Pronari			Të dhënat mbi pasurinë sipas ASHK-së				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë						Vlera totale (lekë)	Shënime
								Shpronësim tokë “truall”			Shpronësim ndërtese banimi (shtëpi)				
	Emër	Atësia	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e truallit (m²)	Sip. e truallit të prekur (m²)	Çmimi i truallit lek/m²	Vlera e truallit në lekë	Sip. e ndërtesës së prekur (m²)	Çmimi obj. lek/m²	Vlera në lekë		
1	Shkëlzen	Nikoll	Beka	1066	59/20	truall	211.8	161.80	3,560	576,008	70.60	32,113	2,267,177.80	2,843,185.80	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
2	Shkëlzen dhe Sugare		Beka	1066	59/26	truall	366.6	366.60	3,560	1,305,096	122.20	32,113	3,924,208.60	5,229,304.60	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
3	Mirash	Fran	Pjetri	1066	59/27	truall	118.9	118.90	3,560	423,284	76.40	32,113	2,453,433.20	2,876,717.20	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
4	Ylber dhe Pashkë		Mrishaj	1066	59/29	truall	500	30.00	3,560	106,800	-			106,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
Vlera totale								677.30		2,411,188	269.20		8,644,819.60	11,056,007.60	

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

**VENDIM****Nr. 356 , datë 16.6.2021****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
DHËNIEN DHE KOHËZGJATJEN E
PUSHIMEVE PËR PUNONJËSIT E
POLICISË SË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. KRITERET PËR DHËNIEN DHE
KOHËZGJATJA E PUSHIMEVE TË
PAGUARA**

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, përveç së drejtës për pushime javore dhe vjetore të paguara, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve, gëzon të drejtën e pushimit të paguar, si më poshtë vijon:

a) për lidhjen e martesës, për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh;

b) për lindjen e fëmijës, bashkëshorti ose bashkëjetuesi që është punonjës i Policisë së Burgjeve, një kohëzgjatje prej 3 (tri) ditësh;

c) për sëmundjen e rëndë ose vdekjen e bashkëshortit/bashkëshortes, bashkëjetuesit/bashkëjetueses, prindërve apo fëmijëve të tij, për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh;

ç) për pësimin e dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore, për një kohëzgjatje prej 3 (tri) ditësh;

d) për ndërrimin e banesës, për një kohëzgjatje prej 3 (tri) ditësh;

dh) për ndërrimin e vendbanimit të përhershëm, për shkak të detyrës, për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh;

e) për përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve akademikë për punën që kryen, për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditësh.

2. Për përfitimin e pushimin e paguar, sipas pikës 1 të këtij kreu, punonjësi i Policisë së Burgjeve paraqet në njësinë e burimeve njerëzore në institucionin ku është i punësuar, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) sipas rastit, dokumentin që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje të paguar sipas këtij vendimi, si:

i. në rastet e përcaktuara nga shkronja “a”, e pikës 1, të këtij kreu, certifikatën e lidhjes së martesës;

ii. në rastet e përcaktuara nga shkronja “b”, e pikës 1, të këtij kreu, certifikatën e lindjes së fëmijës;

iii. në rastet e përcaktuara nga shkronja “c”, e pikës 1, të këtij kreu, raportin mjekësor ose certifikatën e vdekjes;

iv. në rastet e përcaktuara nga shkronja “ç”, e pikës 1, të këtij kreu, vërtetimin nga autoriteti shtetëror përgjegjës që prona, shëndeti ose pasuria e punonjësit të Policisë së Burgjeve është dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore;

v. në rastet e përcaktuara nga shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij kreu, dokumentin që provon shitjen ose transferimin e pronësisë/posedimit mbi banesën e mëparshme dhe fitimin e titullit të pronësisë ose të posedimit mbi një banesë të re, si dhe vërtetimin nga njësi e qeverisjes vendore për banimin në banesën e re;

vi. në rastet e përcaktuara nga shkronja “e”, e pikës 1, të këtij kreu, vërtetimin nga institucioni i arsimit të lartë për regjistrimin e punonjësit të Policisë së Burgjeve në programin nëpërmjet të cilit fitohet titulli akademik;

vii. dhe çdo dokument tjetër të ngjashëm që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje të paguar sipas këtij vendimi.

2. Në rastet kur pushimet e paguara përfitohen për shkaqet e parashikuara nga shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, punonjësi i Policisë së Burgjeve është i detyruar të njoftojë eprorin e drejtpërdrejtë, si dhe njësinë e burimeve njerëzore përpara fillimit të lejes së paguar e të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, jo më vonë se dita e parë e kthimit në punë.

**II. KRITERET PËR DHËNIEN DHE
KOHËZGJATJA E LEJES PA TË DREJTË
PAGE**

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë që të kërkojë leje pa të drejtë page, për:

a) arsye shëndetësore ose personale; si dhe

b) përkujdesjen ndaj fëmijëve, bashkëshortit/bashkëshortes ose prindërve.



2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mund të përfitojë leje pa të drejtë page, sipas pikës 1, të këtij kreu, pas shqyrtimit të kërkesës nga organi përgjegjës, sipas përcaktimit të pikave 6 e 7, të këtij kreu, si dhe pasi është vlerësuar çdo faktor i rëndësishëm, veçanërisht shkaku për të cilin kërkohet leja, kohëzgjatja e saj, planifikimet e lejeve të zakonshme për të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve në institucion, numri i vendeve vakante, si dhe nevoja për të garantuar rendin e sigurinë në institucion.

3. Për përfitimin e lejes pa të drejtë page, sipas pikës 1, të këtij kreu, punonjësi i Policisë së Burgjeve paraqet në njësinë e burimeve njerëzore në institucionin ku është i punësuar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së parashikuar të fillimit të lejes pa të drejtë page, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) sipas rastit, dokumentin që provon shkaktues ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje pa të drejtë page sipas këtij vendimi.

4. Në raste të veçanta, kur leja pa të drejtë page kërkohet për shkaqe që nuk mund të parashikoheshin, punonjësi i Policisë së Burgjeve mund të kërkojë të fillojë lejen jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

6. Kërkesa, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij kreu, shqyrtohet nga drejtuesi i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga data e paraqitjes së saj. Drejtuesi i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, me vendim të arsyetuar, miraton ose refuzon kërkesën për marrjen e lejes pa të drejtë page. Në rastet kur drejtuesi i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale refuzon kërkesën për marrjen e lejes pa të drejtë page, punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së njoftimit, pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, i cili e shqyrton ankimin dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e marrjes së ankimit. Ndaj vendimit për refuzimin e ankimit mund të paraqitet kërkesëpadi në gjykatën administrative kompetente, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi për gjykatat

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

7. Në rastet kur leja e papaguar kërkohet nga drejtuesi i Policisë së Burgjeve, kërkesa paraqitet pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe, në rast se kërkesa refuzohet, ankimi, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, paraqitet pranë ministrit të Drejtësisë.

8. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet për efekt të ecurisë në gradë.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pushimet e paguara, lejet pa të drejtë page dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të punonjësit.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 358, datë 16.6.2021

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT TË NËNSHKRUAR
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE E MINISTRI I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN, DHE
KORPORATËS “ORACLE”, PËR
DHURIMIN E SË DREJTËS PËR TË
AKSESUAR DHE PËRDORUR SISTEMIN
ELEKTRONIK “ORACLE” TË
MENAXHIMIT SHËNDETËSOR
PËR COVID-19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ministri i Shtetit për Rindërtimin, dhe korporatës “Oracle”, për dhurimin e së drejtës për të aksesuar dhe përdorur sistemin elektronik “Oracle” të menaxhimit shëndetësor për COVID-19, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË SHQIPËRISË DHE
KORPORATËS “ORACLE”

Ky Memorandum Mirëkuptimi (“MM”) është bërë në datën _____ ndërmjet Korporatës “Oracle”, me seli në adresën: 500 Oracle Parkway, Redwood Shores, California, U.S.A (SHBA) (Për t’u konfirmuar nëse ky Memorandum Mirëkuptimi do të nënshkruhet në nivel korporate apo rajonal) (“Oracle”) dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Shtetit për Rindërtim, çdo departament tjetër përkatës që përfaqëson qeverinë (Qeveria).

Duke pasur parasysh se Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, nëpërmjet autoritetit të tij të shëndetit publik, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nëpërmjet ministrit të Shtetit për Rindërtim, po punon me partnerë të sektorit publik dhe privat për të përdorur të dhëna dhe teknologji, në mënyrë që të ndihmojë Këshillin e Ministrave të Shqipërisë në parandalimin dhe/ose kontrollimin e përhapjes: 1. të virusit COVID-19; dhe 2. dëmtimeve ose paaftësisë serioze që rezulton nga infeksionet nga virusi COVID-19;

Duke pasur parasysh se korporata “Oracle”, një subjekt privat me seli në Shtetet e Bashkuara, ka marrë përsipër të hartojë, ndërtojë dhe operojë një Sistem të Menaxhimit Shëndetësor për të ndihmuar qeveritë kombëtare në përpjekjet e tyre për të

zvogëluar kërcënimin serioz dhe të pashmangshëm për shëndetin dhe sigurinë e publikut, dhe ndikimet e dëmshme ekonomike dhe ndikime të tjera joshëndetësore të paraqitura nga virusi COVID-19 (“Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit COVID-19” ose “Sistemi”).

Duke pasur parasysh se “Oracle” dhe Këshilli i Ministrave i Shqipërisë (bashkërisht, “Palët”) njohin rëndësinë e përpjekjeve për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në përpjekjen për të adresuar kërcënimin që paraqitet nga virusi COVID-19;

Duke pasur parasysh se Palët pranojnë që mbledhja dhe analiza efektive dhe e sigurt e të dhënave mund të ofrojë përfitime për parashikimin, parandalimin, kontrollimin dhe trajtimin e sëmundjeve të tjera, përveç virusit COVID-19;

Duke pasur parasysh se “Oracle” dëshiron të dhurojë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit “Oracle” për COVID-19, që do të përdoret në lidhje me aktivitetet e shëndetit publik dhe për interesin publik;

Si rrjedhojë, “Oracle”, drejtpërdrejt ose përmes filialit të saj të përshtatshëm, dhe Këshilli i Ministrave synojnë të lidhin marrëveshje për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit “Oracle” për COVID-19, sipas të cilave, për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) nga data e ekzekutimit të marrëveshjeve (afati i “dhurimit të së drejtës për të akses në sistemin elektronik”), “Oracle” do t’i sigurojë Këshillit të Ministrave të Shqipërisë akses në sistem dhe do të operojë dhe do të mirëmbajë sistemin falas, siç përshkruhet më poshtë dhe që do të detajohet me shkrim në marrëveshjen detyruese që do të pasojë. Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë MM për të përshkruar parimet e dhurimit të propozuar të së drejtës për akses në sistemin elektronik, si më poshtë vijon:

A. Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit “Oracle” COVID-19

1. Sistemi përbëhet nga një bazë e të dhënave “Oracle” dhe mjedis/Oracle Analytics Cloud (“OAC”) dhe disa module të programeve të aplikimit që ekzekutohen në platformën “Oracle” Cloud Infrastructure (“OCI”).

2. Modulet e aplikimit përfshijnë, aktualisht, sa më poshtë vijon: Ndjekjen e efikasitetit të terapiës, monitorimin dhe kontrollin e popullsisë, menaxhimin diagnostik dhe Zyrën e Regjistrimit të



Vaksinave. Mundësi ose module shtesë për të mundësuar terapi shtesë, studime dhe elemente të të dhënave mund të shtohen në sistem gjatë kohës së afatit të dhurimit të së drejtës për akses në sistemin elektronik.

B. Dhurimi i së drejtës për akses në sistemin elektronik

1. Dhurimi i propozuar i së drejtës për akses në sistem elektronik do të përbëhet nga një dhurim joekskluziv, në mbarë botën, të kufizuar, i së drejtës për të hyrë dhe përdorur sistemin pa asnjë kosto për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare), sipas një Marrëveshjeje standarde për dhurimin e së drejtës për akses në sistemin elektronik të Shërbimeve të “Oracle Cloud”. Dhurimi i propozuar i të drejtës për akses në sistemin elektronik do të përfshijë akses në secilin modul të zgjedhur të Sistemit, duke përfshirë çdo aftësi ose modul të ri që i shtohet sistemit gjatë afatit të dhurimit të së drejtës për akses në sistem; konfigurimin dhe zbatimin e aftësive standarde në sistem, duke përfshirë konfigurimin, trajnimin, shpërndarjen, mbështetjen e klientit dhe shërbimet e pritjes brenda platformës OCI; integrimet me sistemet e zgjedhura të rëna dakord reciprokisht dhe të kërkuara për ndërveprimin me sistemet ekzistuese; dhe komponentët rezervë me Disponueshmëri të Lartë në një qendër të dhënash brenda Rrjetit të Qendrës së të Dhënave OCI. Si shtojcë e këtij MM-je, do të hartohet një plan-projekt me trajnime specifike, shpërndarje dhe aktivitete mbështetëse për klientin. Këto shtojca do të paraqesin një përshkrim të hollësishëm për rolin, përgjegjësinë dhe kontributet e secilës palë.

2. “Oracle” do të ruajë në mënyrë të sigurt të dhënat e siguruara nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe/ose të caktuarit e tij, do të operojë dhe mirëmbajë sistemin, do të sigurojë përditësime të sistemit, do të gjenerojë raporte dhe panele standarde, siç janë krijuar në modulet e sistemit dhe do t'i bëjë këto të dhëna të disponueshme për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë dhe klinikistët ose të tjerë për analiza të mëtejshme vetëm siç vendoset nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë. “Oracle”, gjithashtu do të ndihmojë Këshillin e Ministrave të Shqipërisë me zhvillimin e rasteve të përdorimit fillestar për përdorimin e sistemit.

3. Dhurimi i të drejtës për akses në ofertën e sistemit elektronik është specifik për platformën

OCI, që vepron në një qendër rajonale të të dhënave brenda Rrjetit të Qendrës së të Dhënave OCI pranë Këshillit të Ministrave të Shqipërisë. “Oracle” është e përgatitur të ndajë në mënyrë konfidenciale detaje shtesë për të trajtuar çështje të aksesit dhe sigurisë, si edhe shqetësimet që kanë qeveritë dhe që do t'i komunikojnë në lidhje me planet dhe veprimet gjatë afatit të dhurimit të së drejtës për akses në sistemin elektronik. Nëse ligjet vendore kërkojnë që të gjitha informacionet e identifikueshme personale, përfshirë informacionin lidhur me kujdesin shëndetësor të individëve të mbeten lokale dhe nëse nuk ka asnjë përjashtim për një krizë të shëndetit publik, një kërkesë për të pasur një sistem lokal në vend të një sistemi qendror të dhënash OCI do të mundësohet me shpenzime të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, i cili do të marrë përgjegjësinë për ruajtjen. Këto kosto do të përfshijnë një investim nga Qeveria, i cili mund të jetë i konsiderueshëm dhe i vazhdueshëm për infrastrukturën (p.sh., hapësirë, harduer, rrjetëzim, siguri etj.), duke përfshirë një qendër të dhënash rezervë me komponentë rezervë me disponueshmëri të lartë, rrjetëzim dhe aftësi të mjaftueshme për sigurinë e të dhënave në mënyrë që të ruajë komponentët e softuerit të sistemit, burime të mjaftueshme për mbështetjen e infrastrukturës për kohëzgjatjen e afatit të dhurimit të së drejtës për të akses në sistemin elektronik, si edhe mirëmbajtjen e softuerit për gjithë kohëzgjatjen e afatit të dhurimit të së drejtës për akses në sistemin elektronik.

4. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë do të ketë pronësinë dhe të drejtat e pronësisë intelektuale në/dhe për të dhënat që mbledh dhe ia ofron sistemit. “Oracle” do të ketë akses të kufizuar në këto të dhëna, në mënyrë që të sigurojë mbështetje teknike, mirëmbajtje të platformës OCI, për të gjeneruar raporte dhe për të administruar dhe vlerësuar performancën e sistemit. Në fund të afatit të dhurimit të së drejtës për akses në sistemin elektronik ose nëse në çdo kohë secila nga palët përfundon marrëveshjen pas njoftimit me shkrim të palës tjetër, të dhënat e Qeverisë do t'i vihen në dispozicion Qeverisë për ritërheqje.

5. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë nuk do të marrë ndonjë të drejtë të shprehur ose të nënkuptuar në pronësinë intelektuale të “Oracle”, përveç së drejtës për të hyrë dhe përdorur sistemin,



siç parashikohet në kontratat e shkruara, detyruese që do të vijojnë.

6. Palët pranojnë që dhurimi i së drejtës për akses në sistemin elektronik do të bëhet në përputhje me dhe do të rregullohet nga marrëveshjet për termat dhe kushtet dhe termat e dhurimit të së drejtës për akses në sistemin elektronik dhe shërbimet “Cloud”, si edhe politika aktuale e asaj kohe e privatësisë së sistemit të menaxhimit të shëndetit “Oracle” COVID-19.

7. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë e pranon dhe kupton që dhurimi i së drejtës për akses në sistemin elektronik do të sigurohet nga “Oracle” pa përfaqësime ose garanci të shprehura apo të nënkuptuara, duke përfshirë ato pa kufizime: asnjë garanci për softuer apo harduer, sistemet, rrjetet apo mjediset apo garancitë e tregtisë, cilësi të kënaqshme dhe të përshtatshme për një qëllim të veçantë.

8. Secila nga Palët e kupton dhe pranon që dhurimi i së drejtës për akses në sistemin elektronik nuk ofrohet dhe nuk do të sigurohet si një nxitje ose shpërblim për blerjen, përdorimin, miratimin ose rekomandimin, ose si dëshmi për çdo produkt ose shërbim “Oracle” nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë ose Ministrinë e tij. Më tej, secila nga Palët e kupton dhe pranon që dhurimi i së drejtës për akses në sistemin elektronik nuk ofrohet dhe nuk do të varet nga blerja e ndonjë produkti ose shërbimi “Oracle” nga Qeveria ose ministrinë e saj, përveç nëse Këshilli i Ministrave i Shqipërisë kërkon që “Oracle” të sigurojë dhurimin e së drejtës për akses në sistemin elektronik në pjesët përbërëse të tij (p.sh., komponentët e menaxhuar nga klienti, të ndara nga komponentët e menaxhuar nga “Oracle”). Palët e kuptojnë që “Oracle” ka ofruar dhurimin e sistemit si zgjidhje e menaxhuar tërësisht nga “Oracle” në një qendër të dhënash OCI dhe nëse Këshilli i Ministrave zgjedh të ruajë komponentët e softuerit të sistemit lokalisht, sesa në një qendër të dhënash OCI, disa harduerë të caktuar dhe parametra konfigurimi do të kërkohen në mënyrë që sistemi të funksionojë me siguri dhe performancë optimale, siç është projektuar.

9. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë konfirmon dhe kupton që duke e kryer dhurimin e së drejtës për akses në sistemin elektronik dhe shërbime të lidhura me të për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh pa asnjë kosto për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë, “Oracle” e bën këtë në këmbim të një

deklarate detyruese mbi imunitetin nga përgjegjësia nga/dhe kundër çdo pretendimi për humbjet e shkaktuara nga ose që rrjedhin nga, të lidhura me ose që rezultojnë nga përdorimi i sistemit.

C. Detyrimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë

1. Këshilli i Ministrave, drejtpërdrejt, nëpërmjet ministrave të tij ose tërthorazi përmes ofruesve të tij të kujdesit shëndetësor dhe sistemeve dhe/ose kërkesave drejt individëve, do të mbledhë të dhënat dhe duke përdorur sistemin dhe aftësitë e tij standarde analize, do të analizojë më tej të dhënat për të informuar vlerësimet e tij të trajtimeve, masave parandaluese, përshtatshmërinë për provat klinike, administrimin, gjurmimin dhe efikasitetin e vaksinave dhe analizave të tjera siç i çmon të përshtatshme.

2. Këshilli i Ministrave do të sigurojë në intervale të rregullta të dhëna dhe specifikime të sugjeruara për elemente shtesë të të dhënave dhe aftësitë e sistemit, për shqyrtim nga “Oracle”.

3. Këshilli i Ministrave do të sigurojë mekanizmat për subjektet pjesëmarrëse (përfshirë klinikistët, mjekët, vendet e testimit, organizatat e kujdesit shëndetësor, si edhe partnerë të tjerë) që të jenë në përputhje me rregulloret vendore që mbrojnë subjektet individuale njerëzore, duke përfshirë marrjen e pëlqimeve të nevojshme për të marrë pjesë dhe për të ndarë kujdesin shëndetësor dhe informacione të tjera personale të identifikueshme.

4. Këshilli i Ministrave do të krijojë një Komitet Drejtues që do të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe personelit tjetër qeveritar, siç garantohet në mënyrë që të sigurojë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet “Oracle” dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe efikasitetin operacional të sistemit dhe proceseve të lidhura me të.

D. Konfidencialiteti

1. Palët bien dakord, me përjashtim të rasteve kur kërkohet me ligj, që të mos zbulojnë ose të bëjnë të disponueshme në çdo formë informacionin konfidencial të njëra-tjetrës, për çdo palë të tretë për ndonjë qëllim tjetër, përveç zbatimit të këtij MM-je, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër. Secila palë bie dakord të marrë të gjithë hapat e arsyeshëm e të nevojshëm për të garantuar që informacioni konfidencial nuk zbulohet ose shpërndahet nga punonjësit ose



agjentët e saj në kundërshtim me termat dhe kushtet e këtij MM-je. Termi “informacion konfidencial” do të kufizohet në termat dhe kushtet nën këtë MM dhe të gjitha informacionet e identifikuar në mënyrë të qartë si konfidenciale. Detyrimet sipas kësaj klauzole do të zbatohen për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data kur informacioni konfidencial i është dhënë palës marrëse.

E. Të përgjithshme

1. Me përjashtim të detyrimeve të Palëve, sipas klauzolës D (Konfidencialiteti) dhe kësaj klauzole E (Të përgjithshme), të gjitha prej të cilave do të jenë ligjërish detyruese, ky MM nuk synon të jetë dhe nuk përbën një marrëveshje detyruese ose të zbatueshme, por është thjesht një përshtkrim paraprak të qëllimit për të lehtësuar diskutimet dhe/ose negociatat dhe përgatitjen e një marrëveshjeje/marrëveshjeve përfundimtare detyruese dhe dokumenteve të lidhura me të, në lidhje me dhurimin e propozuar të së drejtës për akses në sistemin elektronik të lartpërmendur.

2. Asnjë e drejtë ose licencë për ndonjë të drejtë të pronësisë intelektuale të secilës palë nuk është dhënë, transferuar ose caktuar nga ky MM tek tjetra.

3. Secila palë i konfirmon shprehimisht palës tjetër se ka të drejtë (në përputhje me ligjin e zbatueshëm për palën konfirmuese dhe /ose nga dokumentet e organizatës së saj të korporatave ose rregulloret dhe politikat e brendshme) të lidhë këtë MM. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë do të informojë “Oracle” për rregullat e zbatueshme dhe do të sigurojë që aktivitetet e pranuar nga “Oracle”, sipas këtij MM-je nuk do të bien ndesh me rregulla të tilla dhe nuk do të çojnë në skualifikimin e “Oracle” nga asnjë procedurë e prokurimit publik. Pavarësisht nga natyra jodetyruese e këtij MM-je, Palët konfirmojnë se asnjëra palë nuk do të ofrojë, bëjë ose pranojë pagesa ose dhurata (monetare ose të një forme tjetër) për ose nga dikush me qëllim të ndikimit të vendimeve në favor të kësaj pale ose palës tjetër, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me këtë MM.

4. Asnjëra nga palët nuk do të përdorë markat tregtare, logot ose markat e korporatave të palës tjetër, ose nuk do të zbulojë ose nuk do t'i ofrojë publicitet ekzistencës ose përmbajtjes së këtij MM-je pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër. Pavarësisht nga sa më sipër, Këshilli i Ministrave

konfirmon se do të marrë pjesë në shpalljet publike, në lidhje me dhurimin e propozuar të së drejtës për akses në sistemin elektronik dhe qëllimin e tij për të ndihmuar Këshillin e Ministrave të Shqipërisë në parandalimin, kontrollimin dhe trajtimin e sëmundjeve që paraqesin kërcënim për shëndetin publik.

5. Çdo shtojcë e këtij MMM-je do të jetë me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

6. Ky Memorandum rregullohet nga ligjet materiale dhe procedurale të [për t'u konfirmuar] dhe të dyja Palët bien dakord t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv dhe vendndodhjes së gjykatave në [për t'u konfirmuar] për çdo mosmarrëveshje që lind ose lidhet me këtë MM.

F. Përfundimi

1. Secila palë mund të tërhiqet nga/ose të përfundojë këtë MM nëpërmjet një njoftimi me shkrim të dërguar palës tjetër 30 (tridhjetë) ditë para.

Të dyja palët, duke qenë në dijeni të përmbajtjes së këtij MM-je, për të gjitha efektet dhe si provë pranimit, nënshkruajnë si më poshtë:

Për dhe në emër të “Oracle” [emri i plotë i subjektit]

Nënshkruar: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Titulli: _____

Data: _____

Data: _____

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**)

Nënshkruar: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga **ministri i Shtetit për Rindërtimin**)

Nënshkruar: _____

Emri: _____

Pozicioni: _____

Data: _____

**VENDIM****Nr. 359, datë 16.6.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË URËS NË LEZHË
DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI
NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 294 682 990.44 (dyqind e nëntëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë.

2. Bashkisë Lezhë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 58 936 598 (pesëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të urës në Lezhë, në formën e transfertës së pakushtëzuar. Efekti financiar të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, bazuar në rakordimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim.

3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rindërtimin e urës në Lezhë.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 360, datë 16.6.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË DY OBJEKTEVE
ARSIMORE NË BASHKINË
RROGOZHINË DHE CAKTIMIN E
BASHKISË RROGOZHINË
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 310 195 212 (treqind e dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:

a) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 137 062 762 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 173 132 450 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 62 039 042 (gjashtëdhjetë e dy milionë e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 27 412 552



(njëzet e shtatë milionë e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 34 626 490 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 361, datë 16.6.2021

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 130, DATË 13.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” e “iv” dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 130, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësine Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 362, datë 16.6.2021

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 129, DATË 13.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësine Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë